# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5851
E mërkurë, 14 gusht 2019
çmimi 0.40 €


## Instituti i Shëndetësisë jep këshilla për mbrojtje nga temperaturat e larta

FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI FAQE 4-5

# Zgjedhjet e parakohshme çojnë drejt një kthese shpresëdhënëse politike



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se dorëheqja e kryeministrit dhe zgjedhjet e parakohshme çojnë drejt një kthese shpresëdhënëse politike. Ai ka theksuar se zgjedhjet do të duhej ta këndellnin shoqërinë dhe pushtetin e çorientuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka deklaruar se në këto zgjedhje duhet të dalim me vetëdijen se shtetësia e Kosovës nuk është ende punë plotësisht e kryer. Sipas tij, pa njohjen universale, anëtarësimin në OKB, nuk mund të kemi zhvillim normal dhe më të përshpejtuar. Maliqi ka thënë se në këto zgjedhje do të ishte më mirë nëse partitë garojnë veç e veç, por nuk e ka përjashtuar mundësinë e koalicioneve. Megjithatë, ai ka thënë se posti i kryeministrit do të krijojë probleme për arritjen e këtyre koalicioneve

- LDK-ja, PDK-ja, LV-ja DHE AAK-ja DO TË PËRPIQEN TË GAROJNË TË VETME, NDËRSA AKR-JA, NISMA, MBASE EDHE PSD-ja, DO TË KËRKOJNË KOALICION PËR TA SIGURUAR MBIJETESËN

## OPINION

### SHKURT E SHQIP, ANGAZHIMI PËR NDRYSHIM NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XX DHE DY DEKADAT E FUNDIT F. 8

Nga Jakup KRASNIQI



## AKTUALE



### MUSTAFA DHE KURTI KONFIRMOJNË VOTËN PRO SHPËRNDARJES SË KUVENDIT F. 7

### SHQIPËRIA, NDËR VENDET ME PËRQINDJEN MË TË LARTË TË NËNAVE NËN 20 VJEÇ F. 2

## EKONOMI



### SPSPK-ja: PUNËTORËT NË SEKTORIN PRIVAT JANË NË GJENDJE TË RËNDË F. 9

### LIGJI QË NUK I NDALI LOJËRAT E FATIT F. 8

## SPORT

### BESA BËHET ME SPONSORË TË FUQISHËM F. 16

## Të gjitha partitë e duan karrigen e kryeministrit FAQE 3

## Quinti: Kosova ta heqë taksën, Serbia ta ndërpresë fushatën kundër Kosovës FAQE 2


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vendet e Qunitit kërkojnë që Kosova dhe Serbia t'i kthehen dialogut

# Quinti: Kosova ta heqë taksën, Serbia ta ndërpresë fushatën kundër Kosovës

**Qeveria e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë për heqjen pengesave dhe rifillimin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve mes tyre. Sipas deklaratës së përbashkët të vendeve të Quintit, kjo nënkupton që Kosova ta heqë taksën ndaj mallrave të Serbisë, kurse Serbia ta ndërpresë fushatën për heqjen e njohjeve kundër Republikës së Kosovës**



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Vendet e Quintit i kanë bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që menjëherë t'i kthehen dialogut të Brukselit për normalizim të marrëdhënieve. Nëpërmjet një deklarate për medie, qeveria e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë shprehur gatishmërinë e tyre për ta forcuar rolin në këtë proces duke kërkuar nga të dyja palët t'i shmangin veprimet që do të pengonin një marrëveshje përfundimtare e cila është e nevojshme për të dyja vendet për të arritur integrim më të madh euroatlantik dhe përfitimet përcjellëse. "Ne jemi të gatshëm ta forcojmë rolin tonë në këtë proces në përkrahje të përfaqësuesit të lartë të BE-së, por mund ta bëjmë një gjë të tillë vetëm kur ju të jepni shenja të gatishmërisë për kompromis, për heqjen e pengesave dhe rifillimin e bisedimeve. Për Kosovën, kjo nënkupton heqjen e taksave të vendosura ndaj Serbisë. Për Serbinë, kjo nënkupton ndërprerjen e fushatës për heqjen e njohjeve kundër Kosovës", është thënë në deklaratën për medie të Quintit.

Sipas deklaratës së përbashkët të këtyre qeverive, status quoja pengon përparimin e Kosovës dhe Serbisë në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian (BE) dhe thjesht nuk është e qëndrueshme. "Pas viteve të tëra të ngecjes ka ardhur koha që më në fund të përmbyllen konfliktet e viteve të '90-ta dhe të ofrohet një e ardhme e sigurt dhe e begatshme për qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë duke negociuar në mirëbesim një marrëveshje që mund ta mbështesin të dyja palët. Prandaj, i bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë që menjëherë ta rifillojnë dialogun e udhëhequr nga BE-ja dhe kërkojmë nga të dyja palët të shmangin veprime që do të pengonin një marrëveshje përfundimtare, e cila është e nevojshme për të dy vendet për të arritur integrim më të madh euroatlantik dhe përfitimet përcjellëse", është thënë në këtë deklaratë, duke shtuar se ato janë të gatshme të kontribuojnë në çfarëdo mënyre në këtë drejtim. "Ne dëshirojmë të shohim që njerëzit e Kosovës dhe të Serbisë të përfitojnë nga paqja e qëndrueshme dhe të kenë mundësi të ndërtojnë të ardhmen e tyre. Jemi të gatshëm të ndihmojmë në çfarëdo mënyre", është thënë në deklaratën e Quintit.

Në të njëjtën ditë edhe kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se pozicioni i Kosovës është i qartë në këtë proces. Teksa ka treguar se ka pranuar një letër falënderimi nga presidentja e BE-së, Ursula von der Leyen, Haradinaj ka vlerësuar se dialogu Kosovë - Serbi duhet të rifillojë pa kushte. "Qëndrimi ynë tashmë është i qartë: Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të rifillojë pa kushte deri në arritjen e marrëveshjes për njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe besoj se Bashkimi Evropian do të reflektojë për shkaqet e devijimit të dialogut dhe do t'i shtojë përpjekjet për evitimin e temave, siç është shkëmbimi i territoreve e që shpijnë në destabilizim e rajonit tonë", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mirëpritur deklaratën e përbashkët të vendeve të Quintit rreth ecurisë së dialogut Kosovë - Serbi. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova arriti pavarësinë e saj duke pasur në krah një aleancë të fortë me Perëndimin.

Veseli ka thënë se një nga temat mbi të cilat qytetarët do të duhet të vendosin në këto zgjedhje është nëse Kosova dëshiron t'i vazhdojë marrëdhëniet e saj të veçanta me aleatët tanë ndërkombëtarë, apo t'i trajtojë ata si armiq dhe të përpiqet që të mbijetojë e vetme. "Ne duhet t'i mbrojmë interesat e Kosovës, por nuk do të jemi në gjendje ta bëjmë këtë pa partnerët tanë strategjikë. Prandaj, mirëpresim përpjekjet e ShBA-së, BE-së, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë për zhvillimin e dialogut. Megjithatë, ne kërkojmë nga BE-ja që ta parandalojë financimin e strukturave paralele në Kosovë nga Qeveria e Serbisë, t'i ndalojë projektet kolonizuese serbe përmes ndërtimit të lagjeve në veri, të lejohet rindërtimi i shtëpive të djegura atje ku shqiptarët jetonin para vitit 2001, si dhe të dënohen kriminelët dhe përdhunuesit serbë për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të pafajshëm gjatë dhe pas luftës në Kosovë", ka deklaruar Veseli.

## Shqipëria, ndër vendet me përqindjen më të lartë të nënave nën 20 vjeç

TIRANË, 13 GUSHT - Ndonëse të bëhesh prind është përgjegjësi, Shqipëria renditet ndër vendet me përqindjen më të lartë të nënave adoleshente. Të dhënat nga Instat tregojnë se për vitin 2018, rreth 5.21 për qind e lindjeve u kryen nga vajza në moshë më të vogël se 20 vjeç. Edhe pse, në krahasim me një vit më parë, kjo përqindje shënoi ulje nga 5.6 për qind në 5.2 për qind, mbetet një nga më të lartat në Bashkimin Evropian.

Në Bashkimin Evropian pjesa më e madhe e lindjeve (92 për qind) ishin nga gra të moshës 20-39 vjeç. Rreth 4 për qind e lindjeve u kryen nga vajzat në moshë adoleshence dhe po aq nga gratë mbi moshën 40 vjeç.

Pjesa më e madhe e lindjeve nga vajzat në moshë të re (nën 20 vjeç) u kryen në Bullgari dhe në Rumani. Përqindja më e lartë u regjistrua në Bullgari, ku 12.5 për qind e lindjeve në total u kryen nga adoleshentet dhe në Rumani me 12.1 për qind. Më pas ato u ndoqën nga Hungaria me 8.5 për qind dhe Sllovakia me 8.1 për qind.

Në anën tjetër qëndrojnë vendet me përqindjen më të ulët të nënave në moshë të re. Danimarka kishte vetëm 1 për qind të lindjeve të kryera nga nënat adoleshente, Italia dhe Sllovenia me 1.1 për qind, Holanda me 1.2 për qind, Luksemburgu dhe Suedia me përkatësisht 1.4 për qind.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Subjektet më të mëdha politike kanë shprehur pretendimet e tyre për zgjedhjet e reja parlamentare

# Të gjitha partitë e duan karrigen e kryeministrit

**Katër subjektet e mëdha politike kanë shprehur ambiciet e tyre për karrigen e kryeministrit në zgjedhjet e reja. Zyrtarët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) janë shprehur të bindur për fitore në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke thënë se kandidatët e tyre do të jenë kryeministra të ardhshëm të Kosovës. Derisa PDK-ja dhe LV-ja tashmë kanë pranuar se liderët e këtyre partive do të jenë kandidatë për kryeministër, LDK-ja ende nuk e ka gjetur emrin për këtë pozitë. Kurse lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka treguar se nëse nuk ka aktakuzë nga Gjykata Speciale, do të jetë sërish kandidat për kryeministër**




EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ndonëse ende nuk është shpërndarë Kuvendi i Kosovës dhe nuk është caktuar data e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, subjektet e mëdha politike kanë shprehur ambiciet e tyre për pozitën e kryeministrit në zgjedhjet e ardhshme, të cilat pritet të mbahen në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetor.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) tashmë e kanë konfirmuar se liderët e tyre do të jenë kandidatë për kryeministër, kurse Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk ka caktuar emrin e pretendentit për shef të ekzekutivit.

Zyrtarët e lartë të PDK-së kanë bërë me dije se kjo parti më nuk do të bëjë kompromise rreth kësaj pozite, siç ka bërë në dy mandatet e fundit. Lideri i kësaj partie, Kadri Veseli, ka thënë se PDK-ja më nuk do t'ia jep postin e kryeministrit me qira. Madje, Veseli po pretendon se ai do të jetë kryeministër i ardhshëm.

Në takimin që ka pasur të hënën me disa të rinj që kanë emigruar kohët e fundit e të cilët gjenden për pushime në Kosovë, Veseli ka thënë se si kryeministër i ardhshëm do ta ketë prioritet kthimin e këtyre të rinjve. "Është më se e qartë se për t'u ofruar atyre mundësi brenda Kosovës, duhet ta luftojmë nepotizmin në punësimet publike si dhe korrupsionin që po pengon investimet dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Po ashtu, si kryeministër i ardhshëm do të bëjë prioritet fondet për autostradën e punësimit, që do t'i bind këta të rinj e shumë të tjerë që të kthehen e shpërfaqin talentin dhe energjitë", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Facebook".

Zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë bërë me dije se kandidat i kësaj pati për kryeministër do të jetë Albin Kurti. Madje edhe në një koalicion të mundshëm parazgjedhor me LDK-në, të cilin po e duan aq shumë përfaqësuesit e LV-së, ata pretendojnë se pozita e kryeministrit duhet t'i takojë Albin Kurtit.

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Besnik Bislimi, kur është pyetur nga gazeta "Epoka e re" nëse pranojnë të bashkëpunojnë me LDK-së pa postin e kryeministrit, ai ka thënë nuk është aspekt prestigj apo privilegj kjo pozitë. "Pozita e kryeministrit nuk është aspekt prestigji apo privilegji, por më tepër element i rëndësishëm në sinjalizimin e kahut që do të marrë qeveria e re. Në një vend ku nepotizimi e korrupsioni janë avancuar në vlera dhe standard të politikëbërjes dhe në pamundësues të çfarëdo iniciative inovative biznesore, është shumë me rëndësi që qeveria e re ta dërgojë prerazi dhe pa asnjë dyshim sinjalin e vendosjes së luftës ndaj krimit e korrupsionit si prioritet mbi prioritetet e angazhimit të saj", ka thënë Bislimi.

Kurse zyrtarët e LDK-së janë shprehur të bindur se ata janë të parët në zgjedhjet e reja dhe se kryeministër i vendit do të jetë kandidati i këtij subjekti.

Kryetari i rizgjedhur e kësaj partie, Isa Mustafa, ka deklaruar se nuk do të jetë kandidat për kryeministër, por dikush tjetër nga kjo parti. "Unë sigurisht do të bëj përpjekje që të gjej një kandidat tjetër brenda LDK-së dhe vetë ta mbaj timonin e LDK-së, por do të bëjmë përpjekje që bashkërisht të diskutojmë me Këshillin e Përgjithshëm. Këshilli vendos për atë çështje dhe unë tani jam i orientuar që në këtë pozitë të jetë një njeri që ta bëjë mirë këtë punë dhe ta ketë besimin e qytetarëve të Kosovës", ka thënë Mustafa.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit para disa javësh, ka treguar se nëse nuk ka aktakuzë nga Gjykata Speciale, do t'i hyjë garës sërish për pozitën e kryeministrit. "Nëse s'kam aktakuzë do të kandidoj përsëri. Do ta vazhdoj programin tim, atë të konsolidimit të Kosovës dhe të konsolidimit në aspektin ndërkombëtar, e që i bie arritja e një marrëveshjeje me Serbinë", ka thënë Haradinaj.

I vetmi që ka pranuar se nuk do të jetë kandidat për kryeministër në këto zgjedhje është lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Ai ka thënë se nuk do të pranonte që të jetë kryeministër me 7 ose 8 për qind të votave. "Nuk pranoj se me 7 ose 8 për qind të votave të jem kryeministër i këtij vendi. Me deputetë të partive të tjera nuk dua të jem kryeministër. Nëse populli dëshiron të më votojë, e kanë adresën e partisë", ka deklaruar Limaj.

Sipas tij, posti i kryeministrit i takon partisë që del e para në zgjedhje.

Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj, për shkak të ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale, kryesia e Kuvendit ka caktuar 22 gushtin si datë për mbajtjen e seancës parlamentare në të cilën e vetmja pikë e rendit të ditës do të jetë shpërndarja e Kuvendit, në mënyrë që t'u hapet rrugë zgjedhjeve të reja.

## Studentët e Infermierisë të Kolegjit AAB aftësohen përmes praktikës profesionale në QKUK

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Studentët e Kolegjit AAB të Fakultetit të Infermierisë, përveç përvojave që marrin nga ligjëruesit vendorë e ndërkombëtarë gjatë ligjëratave, po shfrytëzojnë edhe mundësitë e bashkëpunimit që ka AAB me Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ata janë duke ushtruar profesionin e infermierit dhe janë ndarë në grupe për ta kryer praktikën profesionale në klinika të ndryshme mjekësore pranë QKUK-së.

Gjatë kësaj periudhe sa ata janë duke e kryer punën praktike u vizituan nga prodekanja e Fakultetit të Infermierisë, Shqipe Tahiri, si dhe nga përfaqësuesit e klinikës gjermane SANA Kliniken AG. Ata u pritën dhe bashkëbiseduan për profesionin e infermierit në Kosovë nga drejtoresha e Infermierisë në QKUK, Lirije Beqiri.

Studentët e Fakultetit të Infermierisë të AAB-së, përveçse janë target i klinikave gjermane për punësim, angazhimin e tyre për ta vazhduar punën e infermierit në Kosovë nuk po e lënë anash, andaj disa prej tyre janë në përfundim të praktikës për ta vazhduar punën e disa të tjerë tashmë kanë filluar praktikën dhe po ofrojnë shërbime profesionale.

Kujtojmë se javën që lamë pas edhe 60 studentë të tjerë të Kolegjit AAB jetësuan kontratat e punës për të vazhduar në mars të vitit 2020 punën në Gjermani.



Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

# Zgjedhjet e parakohshme çojnë drejt



## - LDK-ja, PDK-ja, LV-ja dhe AAK-ja do të përpiqen të garojnë të vetme, ndërsa AKR-ja, Nisma, mbase edhe PSD-ja, do të kërkojnë koalicion për ta siguruar mbijetesën

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se dorëheqja e kryeministrit dhe zgjedhjet e parakohshme çojnë drejt një kthese shpresëdhënëse politike. Ai ka theksuar se zgjedhjet do të duhej ta këndellnin shoqërinë dhe pushtetin e çorientuar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka deklaruar se në këto zgjedhje duhet të dalim me vetëdijen se shtetësia e Kosovës nuk është ende punë plotësisht e kryer. Sipas tij, pa njohjen universale, anëtarësimin në OKB, nuk mund të kemi zhvillim normal dhe më të përshpejtuar. Maliqi ka thënë se në këto zgjedhje do të ishte më mirë nëse partitë garojnë veç e veç, megjithatë ai nuk e ka përjashtuar mundësinë e koalicioneve. Mirëpo ai ka thënë se posti i kryeministrit do të krijojë probleme për arritjen e këtyre koalicioneve

# një kthese shpresëdhënëse politike



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 GUSHT - **"Epoka e re":** *Z. Maliqi, si i komentoni zhvillimet në skenën politike që nga dorëheqja e kryeministrit Haradinaj e deri te caktimi i seancës për shpërndarjen e Kuvendit?*

**Maliqi:** Shpresoj shumë se dorëheqja e kryeministrit dhe zgjedhjet e parakohshme çojnë drejt një kthese shpresëdhënëse politike. Ka ardhur koha për korrigjimin e gabimeve dhe zënkave të pakuptimta që shkaktuan bllokada dhe ngecje dhe që nga viti 2014, penguan zhvillimin normal të Republikës së Kosovës. Dy legjislaturat e Kuvendit dhe dy qeveritë e fundit komprometuan rëndë aftësitë e politikës kosovare që të përballet me sfidat e shtetndërtimit. E gjithë elita politike nuk gjente gjuhë të përbashkët për çështjet vitale dhe prioritare të vendit, që nuk iu nënshtrohen interesave partikulare të partive dhe liderëve. Për më shumë, dështuam edhe në kultivimin e raporteve të koordinuara me faktorët ndërkombëtarë, si partnerët strategjikë të pavarësisë së Kosovës. Ky trend negativ kulmoi me kokëfortësinë e kryeministrit Haradinaj në refuzimin e pezullimit të taksës për mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina, që pa reshtur kërkohej nga ShBA-ja, BE-ja dhe të gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë, aleatë të Kosovës. Pasoja nuk ishte vetëm bllokada e dialogut me Serbinë, por edhe zhgënjimi dhe ftohja serioze e raporteve me aleatët. Të tregohesh arrogant ndaj sugjerimeve të ShBA-së dhe sponsorëve evropianë të pavarësisë, me arsyetimin se taksa po e mbrojtka sovranitetin e Kosovës, është e pajustifikueshme. Kosova duhet të dalë urgjentisht nga qorrsokaku aktual. Zgjedhjet do të duhej ta këndellnin shoqërinë dhe pushtetin e çorientuar. Në zgjedhje duhet të dalim me vetëdijen se shtetësia e Kosovës nuk është ende punë plotësisht e kryer. Pa njohjen universale, anëtarësimin në OKB, mbetemi të gjymtë nuk mund të kemi zhvillim normal dhe më të përshpejtuar. Andaj zgjedhjet tona nuk janë thjesht një matje e re e forcës së partive, se a do të fitojë Kadria, Isa, Albini etj. Si asnjëherë më parë prejse jemi duke ndërtuar sistemin demokratik, kur votojmë partitë, duhet ta vlerësojmë orientimin e tyre bazë, a po angazhohen sinqerisht për arritjen e sovranitetit real të koordinuar me aleatët perëndimorë, apo po përhapin iluzionin se mund ta bëjmë shtetin vetë pa koordinim me aleatët.

**"Epoka e re":** *Në rast se më 22 gusht shpërndahet Kuvendi do të ketë zgjedhje të parakohshme, prisni që subjektet e mëdha politike të garojnë të vetme apo me koalicione parazgjedhore?*

**Maliqi:** Do të ishte më mirë nëse do të garonin veç e veç, por ligji lejon koalicionet parazgjedhore dhe listat e përbashkëta, andaj koalicionet nuk mund të pengohen. Pastaj, koalicionet parazgjedhore janë bërë garë në vete paraprake për ta maksimalizuar votën të subjektit më i votuar, që parapërcaktonte ndarjen e pushtetit. Në vitin 2017 kjo krijoi nervozen dhe frustrimet e subjektet e mëdha, që disa parti të vogla i shfrytëzuan duke kërkuar shpëtimin jo vetëm nga shpata e cenzusit të paarritshëm prej pesë përlindësh, e pastaj edhe për të shantazhuar dhe manipuluar procesin duke kërkuar deputetët dhe pushtet shtesë të pamerituar. Më e paskrupullt ka qenë loja e AKR-së që fillimisht bëri koalicion parazgjedhor me LDK-në, ku menjëherë reaguan, në momentin e fundit PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma dhe krijuan koalicionin PAN. Më pastaj, kur doli se PAN-i ishte subjekt i parë me vota, por nuk kishte deputetë të mjaftueshëm për krijimin e qeverisë, AKR-ja iku nga LDK-ja dhe u lidh me PAN-in, duke e shantazhuar për favore të jashtëzakonshme të pushtetit absolutisht të pamerituara. Mendoj se kësaj here partitë e mëdha do të kujdesen që të dalin vetëm në zgjedhje që të mos bëhen pre e partive e në rastin tonë edhe të grupeve dhe individëve që pa fituar vota, vetëm duke 'ndërmjetësuar' për kuotat e munguara të votave, sigurojnë poste dhe përfitime të larta. Mbase kjo dukuri nuk mund të eliminohet tërësisht por, të paktën, nuk duhet t'i zihet më besë AKR-së së Behgjet Pacollit.

**"Epoka e re":** *Kush më kë prisni se do të bëjë koalicion?*

**Maliqi:** Tendenca kryesore publike është eliminimi i PDK-së nga pushteti. Vetëm ndaj PDK-së pothuajse të gjithë kanë shpallur publikisht 'vijat e kuqe'. Lëvizja Vetëvendosje ka qenë më aktivja, edhe para disa muajve, me planin e bërjes së koalicionit me LDK-në, por me kërkesa kushtëzuese që besoj se këtë koalicion e bëjnë të parealizueshëm. Kësaj here LV-ja nuk flet për koalicion programor, por vetëm për numrat dhe ndarjen e posteve kyçe të pushtetit, ku për vetën kërkojnë kryeministrinë. Por, kryeministrin e do edhe LDK-ja për vete, duke e përqeshur propozimin e LV-së si naiv, sepse ata publikonin edhe emrin e deputetes nga përbërja e LDK-së për ta udhëhequr Kuvendin e Kosovës. LDK-ja, PDK-ja, LV-ja dhe AAK-ja gjithsesi do të përpiqen të garojnë si të vetme, ose me ndonjë parti të vogël që ua sjell disa mija ose qindra vota shtesë. AKR-ja, Nisma Socialdemokrate e, mbase, edhe PSD-ja e Shpend Ahmetit, do të kërkojnë partnerë për koalicion për ta siguruar mbijetesën dhe eventualisht kapjen e ndonjë grimce të pushtetit.

**"Epoka e re":** *Posti i kryeministrit do ta vështirësojë arritjen e këtyre koalicioneve?*

**Maliqi:** Absolutisht. Nëse e keni vërejtur, asnjë parti nuk flet për koalicione programore, por vetëm për ndarjen e posteve. Po i kujtuam zgjedhjet e vitit 2017 LV atëherë garoi si subjekt unik dhe befasoi sepse mori më së shumti vota, e kalonte vetëm PAN-i që garonte si koalicion. Por edhe për LV-në unike kandidati për postin e kryeministrit u pat bërë mollë e sherrit dhe i përçarjes. Një palë e donte Albin Kurtin për kryeministër, tjetra Shpend Ahmetin, dhe kjo edhe i ndau pak më vonë në dy subjekte. LV-ja e Kurtit do të ishte racionale dhe pragmatike, sot do të kërkonte koalicion jo me LDK-në, por me PSD-në, sepse janë më të afërta me synime dhe programe sociale. Sa kam kuptuar, PSD-ja për këtë mundësi tregohet më e arsyeshme, nuk i vë vijën e kuqe LV-së.

**"Epoka e re":** *Çfarë pritjesh keni nga këto zgjedhje, kush do të fitojë e kush do të humbë?*

**Maliqi:** Nga viti 2017 nuk kam bërë sondazhe dhe nuk e kam idenë e saktë nëse ka lëvizje të mëdha në disponimin e elektoratit dhe sa ndikon largimi i një numri bukur të madh të votuesve në Perëndim. Nga ato anketat e instituteve të tjera që i kam parë, nuk jam i sigurt për metodologjinë dhe saktësinë e tyre, kam përshtypjen se do të ketë disa forcime dhe dobësime të partive kryesore, por jo edhe ndryshime decidive, që ndonjë parti të dalë fituese e pastër ose me përparësi të madhe që ia mundëson diktimin e kushteve të koalicioneve pas zgjedhjeve. Do të ishte sukses nëse konfiguracioni i ri i forcave do të lejonte që ndonjëri prej subjekteve të ketë mundësinë e sigurimit të mazhorancës së thjeshtë (61 deputetë) pa deputetët e Listës Serbe. Nëse përsëritet skema e përimtësimit të votave dhe e animoziteteve mes subjekteve të mëdha, sidomos ndaj PDK-së, do të mund të përsëritet zhargitja dhe gjendja djerrakohëse e amullisë që i kemi përjetuar nga viti 2014. Për depërtimet dhe punët e mëdha është dashur të kihet ndërgjegjja e lartë për interesat vitale të shtetit. Edhe pas zgjedhjeve në vitet 2014 dhe 2017 ka qenë e udhës krijimi i koalicionit të madh. Unë i kuptoj vijat e kuqe dhe reagimet ndaj dredhive dhe tradhtive, por ato janë të shpeshta në politikë dhe kur bëhet fjalë për interesa madhore, duhet të tejkalohen ndasitë që vetëm vonojnë proceset. Kjo vlen edhe për koalicionin e paprovuar LDK-LV nëse këto dy subjekte gjejnë pajtimin rreth interesit madhor pa diktate se kush do ta udhëheqë qeverinë. Mendoj se vetëdijesimi për këtë do të shfaqet më natyrshëm pasi që të shpaloset vullneti i shumicës në zgjedhjet që me gjasa do të organizohen në tetor. Nëse garohet ndaras ai subjekt që ka më shumë vota dhe deputetë do të jetë më meritori për ta përfaqësuar vullnetin e sovranit.

## Haziri koordinohet me këshillin e fshatit dhe shoqatën 'Malisheva' për realizimin e programeve të përbashkëta

Gjilan, 13 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të martën në takim këshillin e fshatit Malishevë, në krye me kryetarin Latif Maliqi. Pas takimit, kryetari Lutfi Haziri, duke folur para gazetarëve, ka thënë se qëllimi i takimit ka qenë koordinimi me këshillin e fshatit dhe shoqatën që vepron në Zvicër, për realizimin e programeve të përbashkëta. "Bashkë me këshillin e fshatit dhe Shoqatën 'Malisheva' me seli në Zvicër, po angazhohemi për koordinim të programeve të përbashkëta. Edhe vullnetarët e këtij fshati kanë bërë një punë të jashtëzakonshme përmes këshillit, duke pastruar, mirëmbajtur dhe gjelbëruar hapësirat e përbashkëta. Komuna do të vazhdojë t'i mbështesë programet komunitare në atë që ne i quajmë fshat model, duke përfshirë Malishevën dhe Malishevën e Epërme", ka thënë Haziri.

Ndërkaq kryetari i këshillit të fshatit Malishevë, Latfi Maliqi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për ofrimin e mbështetjes së madhe për realizim të disa projekteve komunitare, përderisa janë pajtuar që një nga mbledhjet e bordit të drejtorëve të bëhet në ambient të hapur në këtë fshat.




# Filluan punimet për ndërtimin e rrugës në zonën turistike prej Epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit




Rahovec, 13 gusht (ER) - Të martën kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës në zonën turistike, konkretisht prej Epopesë së UÇK-së deri te Maja e Shkodranit, aty ku ranë heroikisht dëshmorët e Rahovecit. Në këtë rrugë të gjatë 3.3 kilometra është i paraparë edhe një shteg për çiklizëm.

Projekti që kap vlerën e 175,085.92 eurove është bërë në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, e cila e mbështet me 95 000 euro. "Turizmi është sektor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe mundësi e re për t'i rritur investimet në Rahovec. Ne jemi të përkushtuar të punojmë për këtë qëllim", ka thënë kryetari i komunës, Smajl Latifi.

# Dëmtohet fusha e shahut në Suharekë, Muharremaj kërkon ruajtjen e hapësirave publike

Suharekë, 13 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka kërkuar nga qytetarët e kësaj komune që të përkujdesen për hapësirat publike. Muharremaj, duke komentuar dëmtimin e fushës së shahut në Suharekë, ka thënë se kjo fushë do të rregullohet sërish. "Kjo pamje nuk na nderon. Kujdesi për hapësirat publike duhet ta bëjë secilin të vëmendshëm. Kjo fushë e shahut ishte me pamje më të mirë, por nga persona të pandërgjegjshëm është dëmtuar. Mirëpo ne nuk e humbim shpresën. Kjo do të rregullohet sërish. Dhe, sërish do të kemi shtesë hapësira të gjelbra dhe parqe për të gjitha moshat, kudo ku janë të nevojshme. Sepse qytetarët e meritojnë dhe obligimi ynë është përkushtimi për t'u shërbyer me vullnet dhe gatishmëri kudo ku kërkohet", ka thënë Muharremaj.



## Pastrohen lokacionet në Miradi të Ulët dhe 'Te Pishat në Sllatinë'

Fushë Kosovë, 13 gusht (ER) - Ekipet e punëtorëve të Komunës së Fushë-Kosovës që janë angazhuar në pastrimin e hapësirave publike janë në vlugun më të madh të punëve. Këto ditë ishte fokusi te fshati Miradi e Ulët dhe te parku rekreativ "Te Pishat në Sllatinë". Në Miradi të Ulët, saktësisht në mes të fshatit, u realizua pastrimi i lëndinave që ishin të mbuluara nga barishtet dhe shkurret e shumta, kurse në parkun rekreativ "Te Pishat në Sllatinë" është pastruar gjithë terreni nga mbeturinat e shumta që, fatkeqësisht, shkaktohen nga disa qytetarë. "Luten qytetarët që frekuentojnë parkun rekreativ 'Te Pishat në Sllatinë', që të kujdesen për mirëmbajtjen e ambientit, duke hedhur mbeturinat në kontejnerët e vendosur në pika të shumta në këtë pjesë", është theksuar në njoftimin e komunës së Fushë-Kosovës.



# Mustafa dhe Kurti konfirmojnë votën pro shpërndarjes së Kuvendit

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, dhe ai i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, kanë konfirmuar votën për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës më 22 gusht. Kjo është bërë me dije pas takimit Mustafa-Kurti që është mbajtur të martën në njërin prej restoranteve në kryeqytet. Mustafa e Kurti janë pajtuar që vendi të shkojë sa më parë në zgjedhje të cilat, sipas tyre, duhet të rezultojnë me një qeveri që ua kthen shpresën qytetarëve



EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, dhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, janë takuar sërish të martën për të diskutuar rreth zhvillimeve në skenën politike. Pas këtij takimi ata kanë konfirmuar votën për shpërndarjen e Kuvendit. Mbajtja e takimit fillimisht është konfirmuar nga Kurti e më pas edhe nga Mustafa. Mustafa ka treguar se me Kurtin është pajtuar se jo vetëm që vendi duhet të shkojë sa më parë në zgjedhje, por duhet të rezultojë një qeveri që ua kthen shpresën qytetarëve, veçanërisht rinisë sonë. Sipas tij, qeveria e re e Kosovës duhet të sillet me përgjegjësi dhe kompetencë në zhvillimin ekonomik, në menaxhimin e arsimit dhe shëndetësisë, në luftën kundër krimit, korrupsionit dhe kapjes së shtetit si dhe në hapjen e rrugës së integrimeve evropiane. "Në takim me z. Albin Kurti sot biseduam për gjendjen në Kosovë, sidomos pas dorëheqjes së kryeministrit të vendit. U pajtuam se jo vetëm që vendi duhet të shkojë sa më parë në zgjedhje, por duhet të rezultojë një qeveri që ua kthen shpresën qytetarëve, veçanërisht rinisë sonë. Kjo qeveri e re e Kosovës duhet të sillet me përgjegjësi dhe kompetencë në zhvillimin ekonomik, si në sektorin privat, po ashtu edhe në atë publik, në menaxhimin e arsimit dhe shëndetësisë, në luftën kundër krimit, korrupsionit dhe kapjes së shtetit si dhe në hapjen e rrugës së integrimeve evropiane", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Ndërsa lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka bërë me dije se më 22 gusht grupet parlamentare të këtyre dy partive do të jenë në përbërje të plotë për ta shpërndarë Kuvendin dhe për t'i hapur rrugë zgjedhjeve të reja demokratike.

Kurti dhe Mustafa kanë konstatuar se tashmë shpresa po rikthehet te qytetarët për një të ardhme me drejtësi dhe përparim. "Ky ishte takimi i parë me prof. Isa Mustafën pas rizgjedhjes së tij kryetar i LDK-së. I urova punë të mbarë dhe shëndet. Biseduam për situatën politike në vend dhe për gjendjen e rëndë ekonomike, për nevojën e daljes nga kriza dhe të vendosjes së shtetit në binarët e zhvillimit. Me 22 gusht dy grupet tona parlamentare do të jenë në përbërje të plotë për ta shpërndarë Kuvendin e për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të reja demokratike. Konstatuam që tashmë shpresa po rikthehet te qytetarët, për një të ardhme me drejtësi e përparim", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj për shkak të ftesës për intervistim nga Gjykata Speciale, kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që më 22 gusht të mbahet seanca për shpërndarjen e Kuvendit. Deri më tani nënshkrimet për këtë çështje i kanë dërguar të gjitha partitë politike.

# Veseli me të rinjtë: Së bashku në luftën kundër korrupsionit dhe nepotizmit

EPOKA E RE Qendresa RAMA



PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë në ceremoninë e ndarjes së certifikatave përmes zhvillimit të ndërmarrësisë për të rinj të moshës 18-24 vjeç. Në këtë ngjarje, ku rreth 200 të rinj kanë përfituar prej programit, Veseli ka thënë se Kosova ka shumë mundësi për të ndërtuar kapacitete profesionale në përputhje me nevojat e punës. "Rinia jonë është një aset i jashtëzakonshëm për ta nxitur zhvillimin e vendit tonë e për ta rritur mirëqenien e çdo qytetari. Një ndër shkaktarët kryesorë të gjendjes aktuale është fenomeni i korrupsionit. Unë besoj se duke luftuar korrupsionin dhe duke garantuar sundimin e ligjit ne do të nxisim shumë më tepër investime që do të hapin vende të reja pune", ka thënë Veseli. Sipas tij, duke luftuar nepotizmin do të mund të çlirohet konkurrenca në tregun e punës në mënyrë që t'i jepet mundësi më të talentuarve e më të shkolluarve që të kenë sukses. "Unë kam besim të plotë se ne do t'ia dalim, nëse të gjithë së bashku përpiqemi. Kosova ia ka dalë që të përballë sfida më të rënda në rrethana edhe më të vështira, prandaj jam i bindur që do të kemi sukses edhe në luftën kundër korrupsionit", ka thënë Veseli.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili ka thënë se ky program është shumë i rëndësishëm për të gjithë të rinjtë e Kosovës, e veçanërisht për të rinjtë të cilët janë trajnuar në fushën e ndërrmarrësisë, projekt ky i cili ka për qëllim krijimin e vendeve të punës përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë dhe trajnimeve për ndërmarrësi për të rinjtë pjesëmarrës. Qëllimi i realizimit të projekteve të tilla është që të rinjtë të zhvillojnë kapacitete profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës duke pasur parasysh se vendi ynë ka shumë kuadro që janë të aftë t'i japin shoqërisë ide të reja për biznes", ka thënë Gashi.

Ky program trajnimi është mbështetur nga Ministria e Kulturës.

# Ligji që nuk i ndali lojërat e fatit

Lojërat e fatit janë ilegale pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndalimin e lojërave të fatit në Kosovë, i cili ndalon funksionimin e bizneseve të këtyre lojërave për dhjetët vjetët e ardhshëm. Afër objektit të Qeverisë së Kosovës gjendet një lokal i vogël që vazhdon të funksionojë si bastore sportive. Mund të luash edhe me vetëm një euro ose 0.50 centë, mirëpo tiketë nuk do të marrësh. Atë mund ta fotografosh në ekranin e laptopit, që ta kesh si dëshmi në rast se del tiketë fituese për t'i tërhequr paratë


TASS

PRISHTINË, 13 GUSHT - Rreth 300 metra larg objektit të Qeverisë së Kosovës gjendet një lokal i vogël që vazhdon të funksionojë si bastore sportive, edhe pse me ligj lojërat e fatit janë të ndaluara në Kosovë. Ndonëse tavolinat janë të zbrazëta dhe nuk mund të gjesh asnjë klient që rri aty dhe shikon ndeshjet e futbollit në televizorët e varur në mur, bastet mund të vendosen. Brenda është vetëm një punëtor me një laptop, të cilit i është shtuar puna tani kur pritet të fillojë sezoni i ligave më të forta të futbollit në Evropë dhe në botë. Tiketa të bastoreve nuk mund të gjesh as në shportat e mbeturinave, mirëpo adhuruesit e sportit mund të vendosin bastet online. Dhe krejt kjo është një procedurë e thjeshtë. Mund të luash edhe me vetëm një euro ose 0.50 centë, mirëpo tiketë nuk do të marrësh. Atë mund ta fotografosh në ekranin e laptopit, që ta kesh si dëshmi në rast se del tiketë fituese për t'i tërhequr paratë. Shumica prej atyre që vendosin baste më shpesh janë të abonuar dhe mund të luajnë pa frekuentuar fare këto lokale.

Lojërat e fatit janë ilegale pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndalimin e lojërave të fatit në Kosovë, i cili ndalon funksionimin e bizneseve të këtyre lojërave për dhjetët vjetët e ardhshëm. Ky ligj, sipas avokatit të Shoqatës së Bizneseve të Lojërave të Fatit, Granit Vokshi, ka bërë që kjo veprimtari të bëhet ilegale.

Vokshi ka komentuar arrestimet në ditët e fundit nga Policia e Kosovës për organizim të lojërave të fatit në rajonin e Ferizajt dhe Vitisë, duke shtuar se lajme të tilla do të shohim çdo ditë, derisa një ligj i tillë është në fuqi. "Unë besoj se kjo është pasojë e një vendimi të pamenduar mirë, fillimisht nga ana e Qeverisë së Kosovës, pastaj nga Kuvendi i Kosovës, ku është votuar ky ligj, pa bërë një analizë të mirëfilltë të implikimeve të atij vendimi. Është më mirë që të vendoset një kontroll më rigoroz i veprimtarisë së lojërave të fatit sesa që ato të ndalohen plotësisht ashtu siç janë ndaluar tani, meqenëse prapë po them ndalimi i atyre mund të çojë vetëm në kriminalizim të tyre", ka thënë Vokshi.

### Lojërat e fatit u mbyllën pas vrasjes së dy punëtorëve

Berat Thaqi nga Instituti GAP ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndalimin e lojërave të fatit ka qenë veprim i ngutur. "Fillimisht është dashur të bëhet një paralajmërim dhe të vlerësohet a mund të ketë pasoja juridike sepse, me sa dimë, ato biznese veç kanë qenë duke funksionuar dhe nëse këto biznese kanë pasur licencë, atëherë edhe mund të rrezikohen nga ndonjë dëm buxhetor që mund të vijë nga gjykata. Prandaj, mendoj se është dashur të paralajmërohen këto biznese dhe pastaj të mbyllen", ka thënë Thaqi.

Vetëm gjatë muajit gusht Policia e Kosovës ka arrestuar dhjetëra persona në shumë aksione në komuna të ndryshme të Kosovës. Të arrestuarit dyshohen se me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme kanë organizuar lojëra të fatit edhe pse janë të ndaluara me ligj. Po ashtu, janë kryer disa aksione të bastisjes dhe janë sekuestruar dhjetëra kompjuterë.

Edhe në mbrëmjen e së shtunës Policia e Kosovës ka arrestuar në Ferizaj dy persona nën dyshimin për organizim e skenave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm. Ligji për ndalimin e lojërave të fatit në Kosovë, i cili ndalon funksionimin e bizneseve të lojërave të fatit për 10 vjet, ka hyrë në fuqi në muajin maj të këtij viti. Ky ligj ishte propozuar nga Qeveria e Kosovës, kurse është miratuar në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës më 28 mars të këtij viti. Vendimi për mbylljen e lojërave të fatit është marrë pasi në dy kazino në qytete të ndryshme të Kosovës u vranë dy persona.

# Ministri Tahiri: Jemi të vendosur për konfiskimin e secilës pasuri të fituar me krim e korrupsion

Prishtinë, 13 gusht - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim ushtruesin e detyrës së shefit të EULEX-it, Bernd Thran, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe trendëve të rinj që janë duke zënë vend brenda sistemit të drejtësisë.



Gjatë këtij takimi ministri Tahiri ka kërkuar thellimin e bashkëpunimit në ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me theks të veçantë në konfiskimin e pasurisë së paligjshme. "Ndër politikat më të rëndësishme që kam drejtuar si minister i Drejtësisë ka qenë ajo e konfiskimit të pasurisë së fituar me vepra penale. Sot jemi të vendosur për ta parë drejtësinë në vepër, në konfiskimin e secilës pasuri të fituar nga krimi dhe korrupsioni", ka thënë Tahiri.

Ministri Tahiri ka shtuar se me zbatimin e ligjit të ri për konfiskimin e pasurisë lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të marrë karakter të fuqishëm dhe të pakompromis. "Si shoqëri ne ende kemi sfida që burojnë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar. Përgjigjja më e mirë ndaj këtyre dukurive, përveç ndjekjes penale, është edhe konfiskimi i çdo pasurie të fituar me krim dhe korrupsion, nga gjësendet e imta deri tek asetet multimilionëshe. Ne do ta bëjmë ligjin e ri për konfiskimin e pasurisë armë kryesore kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Zbatimi i këtij ligji duhet të marrë karakter të fuqishëm dhe për këtë, prokurorët dhe gjyqtarët që shërbejnë në sistemin e drejtësisë po përgatiten e duhet të përgatiten edhe më tej", ka thënë ministri Tahiri.

Gjatë takimit u diskutua edhe për masat e Agjendës "Drejtësia 2020" si dhe për proceset e monitorimit të gjyqësorit nga ana e EULEX-it.

# SPSPK-ja: Punëtorët në sektorin privat janë në gjendje të rëndë

Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat në Kosovë (SPSPK) ka reaguar lidhur me të drejtat e punëtorëve në këtë sektor. Sipas SPSPK-së, brenda shtatë muajve 13 punëtorë kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës, ndërkaq edhe tre të tjerë pas lëndimeve të marra në punë kanë ndërruar jetë. Po ashtu, çështje tjetër e reagimit të SPSPK-së ishte edhe pagat e ulëta, orari i tejzgjatur i punës si dhe mungesa e sigurimeve shëndetësore

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 GUSHT - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat në Kosovë (SPSPK) përmes një reagimi për media ka theksuar se gjendja e punëtorëve në sektorin privat është e mjerueshme. Sipas SPSPK-së, brenda shtatë muajve 13 punëtorë kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës, ndërkaq edhe tre të tjerë pas lëndimeve të marra në punë kanë ndërruar jetë. "Shumë punëtorë të tjerë nga lëndimet që kanë marrë në punë më nuk kanë qenë të aftë për t'u kthyer në vendet e tyre të punës", është theksuar në reagimin e SPSPK-së.

Kjo sindikatë ka shtuar se si shkak i mosinteresimit të institucioneve të vendit për t'i rregulluar të drejtat e punëtorëve, disave ua kanë imponuar rrugën e kurbetit. "Udhëheqësit tanë shtetërorë një kategori e shtrydhen si limonin që për vete të krijojnë rehati personale dhe familjare. Shkatërruan fuqinë punëtore profesionale duke ua imponuar atyre rrugën e kurbetit. Përderisa nga viti 2011 e gjerë më sot këta maskarenj pagat e tyre i rriten pesë herë, kurse për ata që derdhin djersën edhe në temperaturë 30 gradë kanë bekuar pagën 130 euro dhe 170 euro. Këtë veprim nuk e bëri as okupatori serb. Në 70 për qind të kompanive tani këta punëtorë janë pa kontrata pune, 90 për qind e atyre që kanë kontrata pune, pushimi i tyre vjetor është vetëm dhjetë ditë. Për shumë punëtorë që dalin në pension pronari i kompanisë nuk ka derdhur asnjë metelik në Fondin Pensional të tyre. Do të thotë, njëzet vjet pas lufte lulëzojnë hotelet, blloqet e banesave, ndërtimet e rrugëve që krejt kjo bëhet me djersen e këtyre punëtorëve, pra të këtyre punëtorëve që nuk u respektohet as e drejta elementare që është e sanksionuar me ligj dhe marrëveshjen kolektive", është thënë në reagimin e SPSPK-së.

Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat në Kosovë ka thënë se qeveritë në vazhdimësi e kanë djegur fuqinë punëtore me paga nënçmuese. "Ua humbët krenarinë atyre që të parët rrezikuan familjet e veta duke mos njohur sistemin dhunues të armikut nga vitet e '90-ta. Ju edhe sot po dhunoni këtë kategori të punëtorëve por, mos harroni, edhe ju do të digjeni por, fatkeqësisht, të fundit", është theksuar në reagimin e SPSPK-së.

Sipas kësaj sindikate, institucionet e vendit me mekanizmat e tyre nuk e zbatojnë Ligjin e Punës dhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve. "Ju nuk keni ligjin mbi sigurimet shëndetësore, nuk krijuat një fond apo mbështetje financiare për punëtorët që vdiqën në vendet e tyre të punës", është thënë në reagimin e SPSPK-së.



## Ujësjellësi "Prishtina" përsërit thirrjen për shpenzim racional të ujit të pijes

PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. ka ripërsëritur thirrjen drejtuar konsumatorëve të saj për shpenzim racional të ujit të pijshëm. Pasi rikujton rënien e nivelit të akumulimeve, nga të cilat furnizohen, kjo kompani në mesazhin drejtuar qytetarëve bën me dije se në botë janë rreth 2.6 miliardë njerëz që jetojnë në zona me rrezik të lartë të mungesës së ujit. "Sot mbi vendin tonë po mbretërojnë temperatura mjaft të larta. Niveli i ujit në liqene akumuluese po bie dalëngadalë. Ne nuk bëjmë pjesë ndoshta në zonat me rrezikshmëri të lartë furnizimi, por nëse sot nuk e ruajmë ujin e pijshëm, nëse nuk e përdorim drejt në periudhë më afatgjatë, rrezikojmë të mbetemi pa të", thuhet në njoftimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina".



# Shkurt e shqip, angazhimi për ndryshim në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe dy dekadat e fundit



Nga Jakup KRASNIQI

Në dy dhjetëvjetëshit e parë, e veçmas në të dytin e shekullit XXI, bisedohet shumë për ndryshim në qeverisjen e vendit, e ndryshimi aq i dëshiruar nuk po ndodh.

Nëse bëjmë një krahasim në mes angazhimeve për ndryshim në gjysmën e dytë të shekullit XX, me dy dekadat e shekullit XXI, ka dallime të mëdha dhe substanciale. Dallime ka shumë, por në këtë rast do të flas vetëm për dallimet në shkallën e rrezikshmërisë.

Çfarë dallime kishte gjatë gjysmës së dytë të shek. XX dhe dy dekadave të fundit, njëra menjëherë pas fitores historike për çlirim nga Jugosllavia e mbetur, respektivisht Serbia, dhe një dekadë pas shpalljes së Pavarësisë më 17 shkurt 2008?

Në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, angazhimi për çlirim e bashkim kombëtar shkallën e rrezikshmërisë e kishte të lartë. Të priste vrasja dhe deportimi i tërë familjes, burgosja dhe dënimi me vdekje, dënime e burgim të përjetshëm, në rastin më të butë, me dhjetëra vjet burgu si dhe shumë pasoja të tjera edhe në pasardhës. Gjatë asaj periudhe kombi ynë mbajti mbi 600 shekuj në burgjet jugosllave, vetëm nga Pranvera Shqiptare, intelektualët dhe rinia shqiptare mbajtën mbi 250 shekuj jetë burgjesh. Shqiptarët gjatë atyre viteve, përfshirë edhe luftën e fundit, patën mbi 80 000 të vrarë, mbi 20 000 dhunime e më tepër se një milion njerëz të shpërngulur nga trojet e tyre etnike. Për popullin tonë, që mbeti jashtë trojeve të tij me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1913, këto shifra konfirmojnë se politikat serbe në Beograd kanë ushtruar krim dhe gjenocid me qëllim të shfarosjes se pjesërishme të shqiptarëve deri në shfarosje të tërësishme.

Përkundër këtyre politikave të krimit e të gjenocidit, që regjimet e Beogradit ndoqën në vazhdimësi ndaj shqiptarëve etnikë, këta të fundit përdorën çdo formë të luftës, aktive e pasive deri dhe luftën çlirimtare, por nuk hoqën dora nga e drejta e tyre për liri, çlirim e bashkim. Nga e drejta për ta ndryshuar pozitën e robërisë me të drejtën për liri e pavarësi. Ndryshimet progresive për zhvillim e përparim në jetën e asnjë kombi nuk kanë ndodhur vetvetiu, për ato ndryshime janë bërë shumë forma të organizimit e të veprimit, për disa të tilla u fol më lart.

Për dallim nga ajo që u tha më lart, në liri e demokraci shfaqet autoritarizmi, krimi e korrupsioni nga njerëzit që në pozita vendimmarrëse, si të pushteti qendror, si të atij lokal, kanë ardhur me votën e lirë të qytetarëve. Për të ndodhur ndryshime sot në Kosovë, nuk ka nevojë për format e angazhimeve e të sakrificave që u përmendën më lart, statistika këto vërtet rrëqethëse, por lypset ndërgjegjësimi i qytetarëve votues për t'i ndëshkuar politikat autoritare, për t'i ndëshkuar me votë të korruptuarit, mashtruesit dhe trafikantët e votave, trafikantët politikë të cilët për para e interesa krejt personale i ndërrojnë partitë si letra tualeti, siç ka ndodhur jo pak me deputetë e ministra, gjë që i kemi parë sa e sa herë deri më tani. Ata që lirinë e pavarësinë e kanë sjellë në këtë derexhe duke mashtruar, duke blerë e duke vjedhur vullnetin qytetar, qoftë në emër të luftës çlirimtare apo rezistencës pasive, nuk mund të ndërtohet shteti i së drejtës. Ecja në rrugën e deritashme, pas partive apo me partitë e proklamuara si të djathta, destinacion tjetër ky vend e komb nuk ka, përveç këtij që e kemi parë dhe po e njohim gjatë dy dekadave të fundit.

Pra, ndryshimi është në duart e qytetarëve votues, të atyre qytetarëve që e dinë peshën e votës së tyre dhe fuqinë e saj për ndryshim. Dhe kjo nuk është vështirë të arrihet, por duhet ditur disa gjëra. Atyre që kanë mashtruar gjatë viteve të shkuara, kurrë më votën! Atyre që ua kanë shitur votën, të mos ua shesin më sepse me atë veprim kanë shitur dhe shesin të ardhmen e tyre e të fëmijëve të tyre. Atyre që ua kanë vjedhur votën, mos t'ua lejojnë më vjedhësve këtë dukuri të shëmtuar, por ta ruajnë votën e tyre të shenjtë si sytë e ballit. Kush ishin këta vjedhës apo përfitues? Disa "komandantë", që thirren në luftë e gjak dëshmorësh, larg apo afër tyre, apo disa paqësorë që thirren në "akademikë" e "akademi" politike, që thirren në ideologji të djathta e grabiten djathtas e majtas! Të tillët duhen dërguar me votën qytetare në muzeun e vjetërsirave! Ndëshkimi me votë i atyre që gjatë gjithë këtyre viteve të qeverisjeve na dhuruan perspektivën e ikjes, është dënimi më meritor, më i shpejtë dhe më efikas. Është, pra, përfundimisht dënimi i duhur!

Ky ndryshim bëhet vetëm me votën e përgjegjshme të qytetarëve, duke krijuar të gjitha mundësitë e domosdoshme dhe më se të nevojshme për ndërtimin e shtetit të së drejtës. Vetëm në shtetin e së drejtës institucionet kushtetuese i kryejnë funksionet e tyre ligjore.

Kjo nuk do të ndodhë pa u bërë hapi i parë, i shumëpritur për perspektivën e vendit, ndryshimi i përfaqësuesve dhe i qeveritarëve me votën e lirë të qytetarëve.

Bashkimi i qytetarëve me të majtën progresive Nismën Socialdemokrate e cila me vendosmëri është shkëputur nga autoritarizmi i cili i ka krijuar probleme të mëdha shtetit dhe kombit. Nisma Socialdemokrate e Kosovës është shpresa e mbetur e ndryshimit në Republikën e Kosovës.

Së këndejmi, ndryshimi në këto hapësira kurrë nuk ka qenë më i lehtë!

# Temperaturat e larta, Instituti i Shëndetësisë jep këshillat për mbrojtje

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 13 gusht** - Gjatë ditëve të fundit në Kosovë kanë mbretëruar temperatura të larta. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka dhënë disa këshilla që duhen aplikuar gjatë ditëve të nxehta. "Personat e moshuar assesi nuk duhet të ekspozohen në rrezet e diellit në intervalin kohor prej orës 10:00-17:00, sidomos jo të moshuarit me sëmundje të zemrës ose ata me diabet; Gjatë daljes nga shtëpia të moshuarit detyrimisht duhet ta mbrojnë kokën me kapelë ose shall; rrobat duhet të jenë të holla, komode, prej liri ose pambuku dhe me ngjyra të çelta. Gjithashtu është e domosdoshme marrja e dy litrave lëngje gjatë ditës, qoftë si tetë gota ujë ose në formë supe ose qaji; po ashtu duhet anashkaluar ushqimin e fërguar, shumë të njelmët ose të ëmbël ose me mëlmesa të shumta, ndërsa duhet marrë shumë pemë dhe perime sezonale", është thënë në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Përveç këshillave të marra nga mjeku për përdorimin e barnave, sipas këtij instituti, tek të moshuarit është e domosdoshme matja më e shpeshtë e tensionit arterial. "Paraqitja e kokëdhembjes, mundimit, marramendjes dhe dehidrimit, tharjes së gojës dhe lëkurës, janë shenja alarmante për të moshuarin, sidomos kur është i sëmurë dhe ka paaftësi funksionale, atëherë doemos i sëmuri geriatrik duhet të lajmërohet te mjeku i tij familjar ose në qendrën më të afërt emergjente", është thënë në këtë njoftim.




Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik më tej ka theksuar se anëtarët e familjes, miqtë, fqinjët dhe anëtarët e OJQ-ve, të cilët kujdesen për të moshuarit gjatë muajve të nxehtë të verës, duhet doemos më shpesh të kontaktojnë me të moshuarit, e në raste të paaftësive funksionale, edhe disa herë gjatë ditës. "Më e rëndësishmja është mirëmbajtja e higjienës personale dhe asaj të ambientit të të moshuarit, si dhe mbikëqyrja e përdorimit të barnave në mënyrë të rregullt. Është i domosdoshëm aktiviteti fizik dhe psikik i të moshuarit, sidomos ecja e vazhdueshme në orët e para të mëngjesit ose në mbrëmje, qëndrimi sa më i gjatë në natyrë (park, shëtitore etj). Nëse i moshuari ka vështirësi për të lëvizur për shkak të pamjaftueshmërive funksionale, atëherë duhet bërë ajrosjen shumorëshe të hapësirave ku qëndron i moshuari", është thënë në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (16)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

Baca i madh, Adem,
E tëra që flitet për Ty, e tëra që shkruhet për Ty, e tëra që bëhet për Ty, e tëra është pak për veprën Tënde! Ti meriton edhe më shumë! Me respekt të thellë, idhulli i popullit shqiptar dhe i kombit tonë! U prehsh në paqe, njeri i madh!

29 korrik 2018,
Prof. Dr. Kajtaz Fazlia, Drenicë

Të persekutuan dhe të dënuan, por, nuk të gjunjëzuan. Të shan dhe të injoruan, por ashtu vetëm të lartësuan! I përjetshëm do të jetë kujtimi për Ty, Bacë!

29 korrik 2018,
Sherafedin Berisha

Adem Demaçi, Hero i Popullit me vlera evropiane!

29 korrik 2018,
Selatin Lupçi

Baca Adem, respekti, nderi dhe vepra jote ka qenë dhe do të mbetet për jetë e mot e pashuar dhe frymëzim për brezat që vijë pas nesh! Vepra juaj do jetë udhërrëfyes për Bashkimin Kombëtar! Me respekt nga qytetarët e fshatit Drenoc të Malishevës!

29 korrik 2018,
Isuf Morina dhe Kapllani

Emri Juaj, Adem Demaçi është Liria, është historia e krejt Kosovës!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)
Përherë lavdi veprimtarisë Tuaj për çështjen kombëtare, Baca Adem. Ne do të punojmë çdo herë derisa të përmbushim idealet Tuaja! Çdo herë do të përulemi para veprës Tuaj. Ishe dhe do të mbetesh mësuesi ynë i atdhedashurisë!

29 korrik 2018,
Kreshnik Xhafolli, Bekim Shulemaja, SH. Çamëria

Baca ishte frymëzues i shumë të rinjve në periudha të ndryshme për çështjen kombëtare. Baca ishte prijësi i shqiptarëve të Kosovës dhe të gjitha viseve ku jetojnë shqiptarët. I përjetshëm qoftë kujtimi për Bacën!
Lavdi Heroi tim dhe gjithë shqiptarëve, Bacës Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
Lulzim Rexhepi, Tenezhdoll

Lamtumirë Baba i Kombit! Mirënjohje dhe respekt të përjetshëm, prej njohjes së parë me "Gjarpinjtë e gjakut". Ke qenë dhe mbetesh frymëzim i çdo shqiptari! Lavdi!

29 korrik 2018,
Kujtim, Arian dhe Malind Llalla

Respekt jetës dhe veprës së Legjendës Shqiptare Adem Demaçit!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I përjetshëm do jetë kujtimi për Bacën Adem Demaçi!

29 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)
S'poštovanjem! Bio si veliki borac i za nas Bošnjake iz Prizrena!

29 juli 2018 (nënshkrimi i palexueshëm)

Me respekt të veçantë për njeriun, i cili bëri atë që të tjerët as nuk guxonin ta mendonin!

29 korrik 2018,
Valdet Rexhepi

Shpresa e shqiptarëve që u lindë dhe u bë Ikonë e Lirisë, demokracisë dhe pavarësisë! Lavdi!

30 korrik 2018,
V. Kasumi

Hipokrizia "patriotike" dhe "banditore" e shqiptaro-titistëve të LKJ-LAK-së të përcolli tërë jetën! Siç u pa edhe në ditën e varrimit Tënd, do të të përcjellë edhe në Vdekje - Jetë, në pavdekësinë Tënde...Por, Ti, pate forcë dhe i fale. Ata e këta e keqpërdoren faljen, shumë herë...
Bacë i lehtë të qoftë Dheu i Shqipërisë së tërë pushtuar shqiptare, nga serbo-kosovaro-malazezët e ndryshëm, në gjashtë shtete "shqiptare" prirë nga LKJ-ja.

30 korrik 2018,
Tafil Duraku

Largimi nga jeta i simbolit të rezistencës shqiptare, Bacë, Adem Demaçit, nuk është një humbje e thjeshtë, por, është ngelja e Kosovës dhe e çështjes shqiptare pa mbrojtje. Ajo që pashë gjatë ceremonive mortore të Tij, është hipokrizi, pasi, sa qe gjallë të gjithë ata që folën në atë tribunë, nuk e respektuan kurrë, ndërsa LDK-ja me mos-respektimin e saj në atë ceremoni dhe me deklaratat që bënë disa përfaqësues të saj, tregoi se edhe pse i vdekur, Ademi është i tmerrshëm për ata.
I përjetshëm qoftë kujtimi dhe vepra e Tij!



30 korrik 2018,
Dilaver Goxhaj
(Shpetim Golemi)

Adem Demaçi është(ishte) një Kolos i cili më shumë se Jetën, e deshi Kombin, popullin e tij. Popull ky, i cili nuk e meritoi-n Dashurinë e Tij!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm), Greme, Ferizaj

Lavdi jetës, heroizmit dhe veprës së Bacës, Adem Demaçit!

30 korrik 2018,
Brigada 135 e UÇK-së, kom. Fatmir Sopi me shokë

Rron, rron përjetë emri dhe vepra e Bacës, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Xhevat Zeka

Të rrallë janë popujt që e meritojnë një shtatvogël kaq të Madh si Ti, Baca Adem...! Nuk e di a jemi të tillë as ne shqiptarët...!

I madh ishe Ti, bacë...! Lavdi e dritë t'pastë shpirti Yt! Me respekt të përgjithmonshëm...

30 korrik 2018,
Isuf Iberdemaj

Baca ishte dhe mbetet Kolosi i Popullit Shqiptar!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Linde, jetove dhe u ndave nga kjo jetë vertikalisht! Krenar që i takova Epokës Tënde dhe të kisha mik e udhëheqës në atdhedashuri! Respekt për jetë të jetëve!

30 korrik 2018,
Demir dhe Brahim Rushiti

Të rrallë janë Kolosët si Ti, Baca, Adem!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi Jetës, Veprimtarisë dhe Heroizmit të Adem Demaçit!

30 korrik 2018,
Sylejman Kryeziu, Leshan, Suharekë

Njeriu dhe shqiptari i madh Adem Demaçi, që gjithçka i fali Atdheut dhe i emër Epokës së Tij! Lavdi jetës dhe veprës se Bacës, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)
Emër njeriu, emër atdhetari, i rrallë strateg, që do të mbetet i përjetshëm, luftëtar për Kauzën shqiptare! Lavdi të qoftë!

30 korrik 2018,
Binak Kastrati

Baca Adem, ishte njëri prej Kolosëve të mëdhenj të çështjes kombëtare! Lavdi jetës dhe veprës se Bacës!

30 korrik 2018,
Arsim Haliti

Krenar për Bacën Adem deri në pafundësi! Ai me vepër thuri lavdinë për së gjalli!

30 korrik 2018,
Azem Zekaj, Istog-Shqipëri

Krenar që të njoha, Bacë!

30 korrik 2018,
Agim (mbiemri i palexueshëm)

Ngushëllime Familjes Demaçi dhe mbarë Kombit Shqiptar, për Bacën Adem. I qoftë i lehtë dheu i tokës së shqiptarisë, nga komandanti i UÇPMB, Shefket Musliu. Lavdi të qoftë përjetë Baca Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Shefket Musliu

Jemi komb krenar që kishim Bacën Adem, simbolin e lirisë dhe të luftës për pavarësi të Kosovës! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës! Lavdi!

30 korrik 2018,
Familja Rama, Koliq

Ti Bacë ishe dhe mbetesh krenaria e Shqipërisë Etnike! Iu qoftë i lehtë dheu i Kosovës, të cilën e deshe aq shumë! Lavdi!

30 korrik 2018,
Milazim Sejdiu, Halil Pecani

Baca Adem Demaçi dhe Baca Adem Jashari, shpëtuan shqiptarinë dhe na sollën Lirinë!

30 korrik 2018,
Shaip Tërholli

Baca Adem, do të jetë përjetësisht në zemrat tona e sidomos në vendlindjen e vet, në Lupçin e Poshtëm (Mur-tur).

30 korrik 2018,
Izet Murturi

**(Vazhdon në numrin e ardhshëm)**

## Anulohen sërish fluturimet në aeroportin e Hong Kongut



**Hong Kong, 13 gusht** - Fluturimet në Aeroportin Ndërkombëtar të Hong Kongut janë anuluar sërish, për të dytën ditë radhazi, për shkak të protestave antiqeveritare.
Aeroporti, i cili është një nga më të ngarkuarit në botë, ka qenë vendi i protestave për pesë ditë rresht. Incizimet tregojnë se pasagjerët po përpiqen të kalojnë përmes demonstruesve, të cilët janë të ulur brenda duke bllokuar nisjet.
Ndërkohë, komisionari i lartë për të drejtat e njeriut i Kombeve të Bashkuara, Michelle Bachelet, shprehu shqetësimin për forcën e përdorur kundër protestuesve gjatë demonstratave masive në Hong Kong dhe bëri thirrje për një hetim të paanshëm. Dhjetë javët e trazirave janë bërë sfida më e madhe për sundimin kinez të qytetit gjysmautonom që nga dorëzimi i tij nga Britania më 1997.
Protestat filluan për të kundërshtuar një projektligj, që do t'i lejonte ekstradimet në territorin e Kinës, por shpejt përparuan në një përpjekje më të gjerë për ta rritur nivelin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

# Bolton: ShBA-ja do ta mbështeste vendimin e Britanisë për Brexit pa marrëveshje

**Uashington, 13 gusht** - Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, John Bolton, u ka thënë zyrtarëve britanikë në Londër se administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dëshiron të jetë bashkëpunuese në procesin e Brexitit dhe se është e gatshme të hartojë një marrëveshje për tregti mes ShBA-së dhe Britanisë. "Ne duam të ndihmojmë për Brexit", ka thënë Bolton para gazetarëve në Londër, pas një takimi me zyrtarë të lartë nga zyra e kryeministrit britanik Boris Johnson. Ai ka thënë se zyrtarët britanikë kanë theksuar se Britania është e gatshme të largohet nga Bashkimi Evropian më 31 tetor. Po ashtu, ai ka bërë me dije se



ShBA-ja do ta mbështeste me entuziazëm një Brexit pa marrëveshje, nëse qeveria britanike merr vendim që të veprojë ashtu.
Kryeministri i ri britanik, Boris Johnson, ka thënë se do ta largojë Britaninë në këtë datë me apo pa marrëveshje nga blloku evropian, derisa ligjvënësit britanikë janë zotuar se do ta rrëzojnë secilën qeveri që tenton ta largojë Britaninë nga blloku evropian pa një marrëveshje.
Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundraull 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

# Bie tregtia Gjermani - Iran për shkak të sanksioneve të ShBA-së

**Berlin, 13 gusht** - Rënia e tregtisë në mes të Gjermanisë dhe Iranit ka dhënë shenja se sanksionet e Shteteve të Bashkuara janë duke ndikuar kur shtetet marrin vendime nëse duhet bashkëpunuar me Teheranin.
Eksportet gjermane në Iran kanë rënë për 48 për qind apo 759 milionë dollarë në gjashtë muajt e parë të këtij viti, ka raportuar agjencia e lajmeve "Reuters", duke pretenduar se disa kompani nuk dëshirojnë t'i prishin raportet me Shtetet e Bashkuara, pasi Uashingtoni ka rivendosur sanksione ndaj Teheranit.
Ngjashëm, edhe shitjet e Iranit në Gjermani kanë rënë në periudhën e njëjtë në 123 milionë dollarë, apo 43 për qind. "Kompanitë gjermane janë të detyruara të zgjedhin në mes të aktiviteteve tregtare në Iran apo Shtetet e Bashkuara, andaj është e qartë se cilën e preferojnë", ka thënë mekanizmi gjerman për tregti, BGA.
Sanksionet e ShBA-së parashohin ndëshkim për kompanitë që bëjnë tregti me Iranin. Prej kur ShBA-ja ka nisur zbatimin e tyre, eksportet e naftës iraniane kanë rënë në 300 000 fuçi në ditë ose më pak. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, ekonomia e këtij shteti do të zvogëlohet për 6 për qind, derisa edhe shkalla e papunësisë mbetet e lartë, 12 për qind.
Presidenti amerikan Donald Trump ka larguar një vit më parë ShBA-në nga marrëveshja bërthamore që Teherani ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015. Sipas marrëveshjes, Teherani lirohet nga sanksionet ndërkombëtare në këmbim të frenimit të aktivitetit bërthamor. Gjermania, Franca dhe Britania, që po ashtu kanë nënshkruar marrëveshjen, kanë tentuar vazhdimisht që ta ruajnë zbatimin e këtij dokumenti. Presidenti Trump ka thënë se ka



gatishmëri për të biseduar me liderët iranianë, pavarësisht fushatës së tij "me presion maksimal", derisa Teherani i konsideron veprimet amerikane si "terrorizëm ekonomik".

# Athina përfshihet nga zjarri

**Athinë, 13 gusht** - Zjarrfikësit grekë të hënën vunë në kontroll një zjarr të madh në pyje që kërcënonte edhe shtëpitë në periferinë e Athinës. Të paktën dy shtëpi u dogjën, por nuk pati raportim për të lënduar pasi policia evakuoi shpejt zonën dhe bllokoi rrugët.
Autoriteti i Mbrojtjes Civile ka njoftuar se zjarri nisi rreth orës tre të mëngjesit në periferinë lindore Peania, në një zonë kodrinore të mbushur me pisha.



Më shumë se 130 zjarrfikës u dislokuan në vendngjarje për ta ndaluar përhapjen e flakëve në zonat e banuara përreth. Edhe avionët zjarrfikës nga qielli ndihmuan në operacion.
Greqia është prekur nga një numër vatrash zjarri që nga fundjava kur erërat e forta dhe temperaturat rreth 40 gradë celsius ndihmuan në përshkallëzimin e situatës.
Të dielën një zjarr në ishullin Elafonisos në rajonin e Peloponezit u vu nën kontroll pas dy ditësh përpjekje. Vlerësohet se është djegur thuajse çereku i ishullit çka edhe ka detyruar autoritetet të evakuojnë një kamping dhe një hotel.
Dy zjarre të tjera u shuan të shtunën në maratonë, afër Matit, resorit bregdetar ku vitin e kaluar humbën jetën 102 persona, në katastrofën më të rëndë si pasojë e zjarreve të regjistruar në Greqi. Shërbimet e emergjencave janë në gatishmëri të lartë që nga e premtja, pasi ekspertët nënvizuan se kjo ishte hera e parë që nga viti 2012 që në vend shihej një kombinim i kushteve kaq të rrezikshme, temperaturë e lartë, erë e fortë dhe lagështi e ulët.

## Stephen Biegun pritet të jetë ambasador i ShBA-së në Rusi



**Uashington, 13 gusht** - I dërguari i Shteteve të Bashkuara në Korenë Veriore, Stephen Biegun, ka mundësi të emërohet ambasador i ri në Rusi nga presidenti amerikan Donald Trump, ka raportuar "Vox News" dhe "Reuters", duke cituar burime familjare me këtë çështje në Shtëpinë e Bardhë.
Ambasadori aktual, ish-guvernator në Utah, Jon Hunstman, që do të largohet nga Moska më 3 tetor, është raportuar se mund të kandidojë sërish në pozitën e guvernatorit. Ai ka shërbyer në Rusi nga tetori i vitit 2017.
Biegun, që është i njohur si ekspert për Rusinë, ka kaluar kohë në Këshillin për Siguri Kombëtare gjatë udhëheqësisë së ish-presidentit amerikan George W. Bush si ndihmës për çështje të sigurisë.

# KËNDVËSHTRIMET RADIKALE TË SUSAN SONTAGUT VAZHDOJNË TË NDIKOJNË NË MËNYRËN SE SI E SHOHIM FOTOGRAFINË



ALINA COHEN

Fotografia, më shumë se çdo formë tjetër e artit, është subjekt i shqyrtimit intensiv moral.

Ne shqetësohemi për shtimin e imazheve të dhunshme, për aprovimin e subjekteve për të qenë të fotografuar, frikësohemi se fotografitë e manipuluara do të krijojnë keqpërdorime të dëmshme të çështjeve kritike dhe shqetësohemi se shkrepja e fotografive në mënyrë të tepruar zvogëlon aftësinë tonë për ta përjetuar botën. Këto shqetësime mund të konsiderohen të çastit dhe si të bëra me kohë, por shkrimtarja Susan Sontag të gjitha këto shqetësime i kishte artikuluar qysh në fund të viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar.

Përmbledhja e eseve të Sontagut e vitit 1977, me titullin "Për fotografinë" (On Photography) është, ndoshta, libri më i çmuar dhe më me ndikim që është shkruar ndonjëherë për këtë medium. Edhe pse tani konsiderohet një tekst inovativ i rëndësisë artistike-historike, Sontagu nuk ishte artiste profesionale dhe as akademike: ajo vazhdimisht është përqeshur si "intelektuale publike". Stili i saj bindës i të shkruarit dhe aprovimi i plotë i statusit prej amatores bëri që idetë e saj të depërtojnë kudo - pavarësisht prej paraqitjes së shumë kritikuesve. Shkrimtari Tom Wolfe e quante "edhe një shkrimtare e cila e kaloi jetën duke u paraqitur në takime protestuese dhe duke u ngjitur në podium e ngarkuar me stilin e saj prozaik". Studiuesja Camille Paglia e akuzonte se po shndërrohej në një "sinonim të llojit të cekët të mashtrueses". Prapëseprapë, mendimet radikale të Susan Sontagut kanë mbetur të fuqishme si çdoherë.

E lindur në vitin 1933, Sontag ka shkruar drama, ese dhe novela deri në vdekje (2004). Nuk kishte asnjë edukim formal në fushën e artit apo fotografisë - studioi gjuhën angleze dhe filozofinë në Harvard, por nga viti 1959 u bë pjesë e skenës kulturore nju-jorkeze. Burimi i interesimit të saj për fotografinë diskutohet dhe analizohet edhe sot. Krahas punës në këtë temë, Sontag u bë e njohur me esetë kundër luftës dhe shkrimet që ajo ua kushtonte sëmundjeve dhe llogoreve. Libri i saj eseistik i vitit 1964, "Shënime për kampin" - një analizë radikale tejet e thukët dhe me ndjeshmëri të veçantë, e ndihmoi atë të bënte emër dhe u bë inspiruese e temave të Met Galas për këtë vit (Costume Institute Gala). Duke festuar vazhdimisht dhe duke u tallur gjithë jetën, Sontag u bë ikonë: elegante, e çuditshme, e zëshme dhe brilante.

Në biografinë kushtuar shkrimtares që pritet të dalë në shtator të këtij viti (2019), nga autori Benjamin Moser, "Sontag: Jeta dhe vepra e saj", ajo përforcohet edhe më tej si një mendimtare me karakter të jashtëzakonshëm. Ndër të tjera, në faqet e librit jepet edhe informata se Sontag në vitet e e njëzeta kishte shkruar një biografi të madhe për Sigmund Freudin, porse krejt meritat për të i kishte marrë burri i saj.

Edhe pse shkruante për artistët dhe estetikën, bindjet politike mbështetën argumentet e Sontagut. Shqetësimet e saj të vërteta rreth fotografisë kishin ndikim marksist. Ajo e trajtoi "turpin klasor" në veprën e August Sanderit, i cili bëri fotografitë e gjermanëve në fillim të vitit 1911. Sontagu vuri në dukje se ai realizoi portrete të të pasurve në ambiente të mbyllura derisa punëtorët dhe të braktisurit paraqiteshin në vende dhe me rekuizita që nënkuptonin profesionet e tyre. Strategjia e fundit, shkruante ajo, e paraqet klasën e ulët sikur nuk ka "lloje të identiteteve të veçanta që arrihen zakonisht te klasa e mesme dhe e lartë shoqërore". Nëse e duam një shoqëri me të drejtë, thotë Sontag, mund të fillojmë të mendojmë se kë e fotografojmë dhe si e përshkruajmë atë që po fotografojmë. Sander pothuajse është i vetmi fotograf të cilin Sontag e fajëson që objektivin e tij e ka shfrytëzuar për t'u kënaqur me "turizmin klasor". Ajo theksonte se Edward Steichen, Bill Brandt, Henri Cartier-Bresson dhe Richard Avedon janë të gjithë ose shumë të pasur, ose shumë të varfër apo të dyja bashkë.

Ani pse Sontag është marrë me karrierën e disa fotografëve, ajo vlerësohej më shumë për diskutimet e saj të gjëra kushtuar përhapjes së fotografisë. Ajo thirrej në natyrën e varësisë që krijon aparati fotografik, por paralajmëronte se shkrepja e fotografive jep vetëm "një shfaqje të pjesëmarrjes". Lidhja jonë e zjarrtë me "Instagram"-in sot, është dëshmia më e mirë e parashikimit të saj. Kur bëjmë një fotografi, ne në thelb eshkëpusim veten nga bota dhe njerëzit rreth nesh. Bërja e fotografive me obsesion është tjetërsuese - ata që janë më të pangopurit nga ushqimi i "Instagram"-it, sipas logjikës së Susan Sontagut, mund të jenë më të izoluarit, pavarësisht prej postimeve të tyre të fotografive me diell.

Por, edhe më shqetësuese ishte shpallja e aparatit fotografik nga Sontagu, si një armë. "Të fotografosh njerëz është sikur t'i dhunosh ata", shkruante ajo. Sa më shumë imazhe dhune që shohim nga luftërat; të viktimave të urisë apo të të urituve; apo padrejtësi të tjera - aq më imun karshi tyre bëhemi ne.

Vitet e fundit lëvizja Black Lives Matter (Jeta e afro-amerikanëve ka vlerë - v. i.) ka kundërshtuar qarkullimin e fotografive që tregojnë dhunë kundër trupit të zi. Kjo çështje zuri fill te protestat e vitit 2017 në Muzeun "Whitney", që sfiduan një përshkrim të një piktoreje të bardhë (Dana Schutz) që i bëri një fotografi të Emmett Tillit të gjymtuar në arkivolin e tij (Emmett Till ishte 14-vjeçari afro-amerikan i linçuar nga racistet e bardhë, në vitin 1955).

"Fotografitë tronditin edhe kur ato tregojnë diçka përshkruese", shkruante Sontag katër dekada para këtij shqetësimi apo proteste. "Për fat të keq, pakënaqësitë vijnë duke u shtuar - pjesërisht shkaku i shtimit të madh të imazheve me përmbajtje të tmerrshme".

Më shumë se çdo kritik tjetër i shekullit XX, Sontag u dha lexuesve një arsye për t'u kujdesur për fotografinë. Qoftë në nivel të ndërgjegjshëm ose të nënndërgjegjshëm, imazhet që na bombardojnë çdo ditë ndikojnë në mënyrën se si ne e përshtatim ndjesinë tonë karshi moralit dhe perceptimit të botës. Në vitin 2019 shkrimet e saj ende udhëzojnë për një vështrim më të kujdesshëm, për shkrepjen e fotografive dhe marrjen në konsideratë të mënyrës se si ne e përjetojmë aq shumë jetën moderne: përmes ekraneve dhe lenteve.

***Përktheu: Fahredin SPAHIJA***

(Marrë nga numri i gjashtë i revistës "Akademia")



E jashtëzakonshme

# Irani prezanton qilimin 600 metra të gjatë



Qilimi më i madh në botë me gjatësi 600 metra u prezantua në Panairin Ndërkombëtar të Qilimave të punuar me dorë në Tabriz. Ai është punuar në 60 modele dhe 70 ngjyra, ndërsa peshon tre ton. Për këtë janë nevojitur gjashtë vjet punë në dy ndërrime.

FOTO E DITES



Dy këlyshë të bardhë luani, të quajtur Nala dhe Simba, shihen të shtrirë në një shportë në shoqatën "Caresse de tigre" në Francë. /AFP/

E rrallë

# Për herë të parë treni me shpejtësi të lartë në dispozicion gjatë pelegrinazhit të Haxhit



Treni me shpejtësi të lartë do të jetë në dispozicion për herë të parë këtë vit gjatë pelegrinazhit të Haxhit, nga myslimanët në qytetin e shenjtë të Mekës së Arabisë Saudite. Disa nga miliona pelegrinët që pritet të bëjnë udhëtimin do të hipnin në këtë tren (HHR), i cili lidh Mekën me Medinën dhe kalon nëpër tri stacione: Jeddah, Aeroporti Ndërkombëtar i Mbretit Abdul Aziz dhe Qyteti Ekonomik i Mbretit Abdullah në Rabigh, sipas faqes së internetit të hekurudhave. Në vitin 2018, 2.37 milionë myslimanë bënë udhëtimin për në Mekë.

## BARSOLETA E DITËS



**E dashura: Zemër, qysh i fiton paratë?**
**I dashuri: Duke shkruar.**
**E dashura: Çfarë shkruan?**
**I dashuri: I shkruaj babës në Zvicër që s'kam para!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Çdo ditë në ora 15:30**

### "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts







**Çdo ditë në ora 17:30**

### "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
**Regjia:** Jon Favreau

**Në ora 19:30 dhe 22:00**

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
**Regjia:** David Leitchu







**Nga dt. 08.08.2019**

### "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Nuk është se keni arritur të zgjidhni çështje që ju kanë shqetësuar këto kohë. Kjo gjë ju ka sjellë më shumë stres se zakonisht.



**DEMI**
Keni fituar pavarësi morale dhe financiare nga e shkuara juaj. Për këtë arsye jeni bërë më tolerant dhe më të hapur me të tjerët.



**BINJAKËT**
Një detaj që po ju ha shumë kohë dhe po ju mundon sot më në fund do të gjejë zgjidhje. Ju doni të jeni i përkryer dhe do t'ia arrini qëllimit.



**GAFORRJA**
Keni filluar të keni më shumë besim tek personat që ju rrethojnë dhe jo gjithmonë shtyheni nga instinkti për të zgjidhur një problem.



**LUANI**
Nuk keni shumë kohë për mëdyshje dhe dyshime sot. Njerëzit tuaj të dashur do t'ju kërkojnë ndihmë dhe duhet të jeni të gatshëm pa asnjë rezervë.



**VIRGJËRESHA**
Keni zgjedhur mënyrën më të thjeshtë për të mos pranuar ndjenjat tuaja, duke shmangur një person të caktuar. Do të pendoheni më vonë.



**PESHORJA**
Komunikimi është shumë i rëndësishëm sot. Nëse nuk bisedoni si me kolegët, ashtu edhe me partnerin, çështjet e mbartura nuk do të gjejnë zgjidhje.



**AKREPI**
Një person ka krijuar një ide të gabuar për ju që nuk i korrespondon realitetit. Nëse doni të sqaroheni mund ta ftoni për një takim.



**SHIGJETARI**
Keni vënë baza të forta për të ardhmen tuaj profesionale dhe jeni mjaft të qetë ndaj çdo ndryshimi që mund të ndodhë.



**BRICJAPI**
Duhet t'i mirëkuptoni pjesëtarët e familjes sot që nuk do të aprovojnë një vendim tuajin që dashur pa dashur i kushtëzon edhe ata.



**UJORI**
Nuk keni zgjidhje tjetër sot përveçse ta merrni në dorë situatën dhe të mundoheni t'i zgjidhni ngërçet e krijuara sepse mund t'ju prishin punë.



**PESHQIT**
Keni qenë shumë të ndjeshëm ndaj ngjarjeve dhe personave që keni pasur pranë, por tashmë keni ndryshuar qëndrim nisur nga një situatë e caktuar.

# Lady Gaga jep donacione për nxënësit në Dejton, El Paso dhe Gilroy pas sulmit masiv



Lady Gaga do të japë donacione në tri qytetet ku ndodhën të shtënat masive në ShBA. Këngëtarja "Bad Romance" do të sigurojë fonde për 162 klasa në Dejton, Ohio, El Paso, Teksas dhe Gilroy, Kalifornia. "Zemra ime është me ata që u larguan nga ne dhe me familjet e tyre, të dashurit dhe komunitetit që kanë mbetur të pikëlluar", ka shkruar në rrjetet sociale Gaga, e cila ka njoftuar se do t'i dhurojë donacionet në 162 klasa mësimore përmes "Donors Select".

# Kate Middleton pas dhjetë vjetësh del sërish me pantallona të shkurtra në publik





Kate Middletoni u shfaq sërish në media. Dukesha 37-vjeçare e Cambridges javën e kaluar shkoi në Regatta të King's Cup në Angli në një garë me vela. Por ajo që ngjalli komentime në këtë garë bamirësie ishin pantallonat e shkurtra të dukeshës. Para se të hipte në një varkë, Middleton ishte e veshur me një xhaketë sportive, kapelë bejsbolli dhe pantallona të shkurtra marine.



# Rita Ora performon në Portugali

Këngëtarja e njohur nga Prishtina, Rita Ora, ka performuar dje në festivalin Meo Sudoeste i cili mbahet në Portugali. Ajo menjëherë pas pushimeve në Ibiza iu kthye skenës dhe adhuruesve të saj. Ora pati të veshur një kostum të zi dhe elegant, i cili kishte shkëlqim dhe e bënte këngëtaren të duket seksi.

# Kylie Jenner me veshje 5 635 dollarëshe nga "Versace" shëtitet në Itali



Kylie Jenneri është në Itali me të dashurin e saj, Travis Scott, vajzën Stormi dhe një numër të madh të familjarëve dhe miqve duke u përgatitur për ta festuar ditëlindjen e 22-të. Ajo bashkë me reperin 27-vjeçar dhe foshnjën e tyre tetëmbëdhjetë-muajshe shkuan në "Versace". Miliarderja më e re në botë veshi një fustan me shumë ngjyra, çantë dhe syze, të gjitha këto të "Versaces", që kapin vlerën e 5 635 dollarëve.





Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Besa bëhet me sponsorë të fuqishëm

Ligji për Sponsporizim në fushën e sportit ka filluar t'i sjellë frytet e para. Pas disa klubeve të futbollit, edhe Besa e Pejës brenda javës do të bëhet me sponsorë të rinj. Pritet që me mbështetjen e ELKOS Group dhe Korporatës "Dukagjini", Besa të rikthejë lavdinë e dikurshme në futbollin pejan



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Skuadra e Besës së Pejës në fund të muajit të kaluar kishte paralajmëruar se është afër marrëveshjes me ELKOS Group dhe Korporatën "Dukagjini". Klubi pejan nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare kishte njoftuar se është afër finalizimit të marrëveshjes me dy kompanitë e mëdha pejane, kurse këtë javë do të bëhet edhe zyrtarizimi. "Jemi pranë finalizimit te marrëveshjeve me dy kompani të mëdha dhe serioze si ELKOS Group dhe Korporata 'Dukagjini'. Me inkuadrimin e këtyre dy gjiganteve financiarë, ne si FC Besa jemi të sigurt se lavdia e dikurshme dhe mbizotërimi i FC Besa në futbollin kosovar është e sigurt", thuhej në njoftimin e Besës. "Marrëveshja është arritur dhe gjatë kësaj jave pritet të vijë konfirmimi i Administratës Tatimore të Kosovës për lejimin e sponzorizimit të klubit nga dy kompanitë gjigante siç janë ELKOS Group dhe Korporata 'Dukagjini'. Besa do të jetë një skuadër serioze në Ligën e Parë dhe pretendentja kryesore për inkuadrim në IPKO Superligë", ka thënë një burim i gazetës brenda klubit. Tri herë kampionia e Kosovës në futboll në edicionin e ri futbollistik do të drejtohet nga trajneri Miftar Rama. Nën drejtimin e Ramës klubi pejan është duke zhvilluar stërvitje intensive për edicionin e ri. Deri tash i vetmi futbollist që zyrtarisht është larguar nga Besa e që ishte pjesë e saj në edicionin 2018/2019 është Liridon Balaj. Talenti i ri pejan është transferuar në skuadrën e FC Aarau në Zvicër.

### Besa e rikthen Durakun

Skuadra e Besës ka filluar përforcimet për edicionin 2019/2020. Pas transferimit të veteranit Dugagjin Gashi, kjo skuadër ka arritur marrëveshje edhe me mesfushorin tjetër veteran Mensur Duraku. Arritjen e marrëveshjes për gazetë e ka bërë me dije vetë futbollisti Duraku, i cili ka qenë pjesë e klubit pejan edhe në të kaluarën. "Tash e tutje jam futbollist i Besës, kurse marrëveshja është një jeçare. Shpresoj ta ndihmoj klubin e zëmrës të rikthehet aty ku e ka vendin, në Superligë. Aktualisht pjesë e Besës janë edhe disa lojtarë cilësorë dhe në ditët e ardhshme priten edhe përforcime të tjera", ka thënë Duraku.

## SHKURT

### Llapi prezanton Mazrekajn

Kalimi i Mentor Mazrekajt në skuadrën e Llapit të martën është bërë zyrtar, derisa anësori është prezantuar me fanellën e skuadrës së re. "Sulmuesi i krahut, Mentor Mazrekaj, nga dita e sotme do të jetë pjesë e Llapit. Mazrekaj me bagazh të madh në futbollin kosovar dhe atë shqiptar ka përforcuar edhe më shumë radhët e Llapit. Futbollist me përvojë të madhe. Spikasin paraqitjet e tij me Partizanin e Shqipërisë, teksa ka qenë pjesë e Prishtinës dhe Ferizajt", thuhet në njoftimin e Llapit. Mentor Mazrekaj u paraqit për herë të parë në stërvitje teksa futbollistët dhe stafi i trajnerëve të Llapit i dëshiruan mirëseardhje në klubin nga Podujeva.

### Agim Ademi merr pjesë në Superkupën e Evropës

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, me ftesë të UEFA-s do të marrë pjesë në takimin e UEFA-s si dhe do të jetë mysafir në ndeshjen e Superkupës së Evropës ndërmjet fituesit të Ligës së Kampionëve, Liverpoolit dhe fituesit të Ligës së Evropës, Chelseas. Gjatë qëndrimit treditor në Stamboll, përveç takimit të rregullt të UEFA-s, presidenti Ademi do të zhvillojë edhe takime të tjera me drejtuesit e Federatës së Futbollit të Turqisë si dhe me homologët e federatave të tjera.

### Morina përforcon KB Ylli

KB Golden Eagle Ylli është përforcuar me basketbollistin e njohur Altin Morina. Basketbollisti që simpatizohet shumë nga tifozët e Golden Eagle Yllit është rikthyer në këtë skuadër për t'i ndihmuar në edicionin e ri për t'i arritur objektivat. Morina karakterizohet me depërtime të shpejta dhe gjuajtje të sigurta.

## Ferizaj kalon në shoqëri aksionare

FERIZAJ, 13 GUSHT - KF Ferizaj ka marrë një lajm të mirë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë derisa është licencuar si shoqëri aksionare. Klubi është shndërruar në shoqëri aksionare. Investitorët e huaj nga Anglia do të kenë 51 % të aksioneve, ndërsa vendorët 49 %. Klubi ka filluar përgatitjet për sezonin e ri dhe ditë më parë ka emëruar trajner Bekim Isufin. Ky i fundit do të debutojë të dielën ndaj ish-skuadrës së tij, Dritës. "Klubi ynë është në shoqëri aksionare. Zyrtarisht morëm certifikatën e biznesit për klubin tonë, i cili edhe zyrtarisht është pjesë e shoqërisë aksionare. Urime Ferizaj", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ferizajt.



## Ronaldo: Ky është dallimi im me Messin



**Torino, 13 gusht** - Rivaliteti midis Cristiano Ronaldos dhe Leo Messit ishte shumë i madh gjatë kohës kur portugezi luante në Spanjë për Real Madridin. Pavarësisht se 34-vjeçari tani luan për Juventusin, përsëri rivaliteti me argjentinasin vazhdon, teksa të dy janë në garë për ta fituar "Topin e Artë". Gjatë një interviste Ronaldo është pyetur për dallimin midis tij dhe yllit të Barcelonës. "Unë kam luajtur për disa klube dhe kam fituar Ligën e Kampionëve me klube të ndryshme. Kam qenë për 6 vjet me radhë golashënuesi më i mirë në këtë kompeticion. Nuk ka shumë lojtarë që kanë fituar 5 trofe të Ligës së Kampionëve dhe për këtë besoj se mund ta identifikoj veten me kompeticion. Messi është një lojtar i shkëlqyer, i cili do të mbahet mend jo vetëm për 'Topat e Artë', por edhe për përmirësimin, vit pas viti, ashtu si mua. Unë çdo ditë zgjohem me idenë që të stërvitem me qëllimin për të marrë gjithmonë diçka më shumë dhe jo vetëm për të fituar. Faleminderit Zotit! Nuk më mungojnë paratë dhe ajo që dua të fitoj është një vend në historinë e futbollit", u shpreh Ronaldo.

# Salihu: Klubet duhet të luajnë futboll jo të merren me politikë




**Prishtinë, 13 gusht** - Kanë mbetur më pak se 1 javë deri tek fillimi i stinorit të ri në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Evropa, transferimet, faza përgatitore dhe shumë gjëra të tjera do t'i lënë vend garës së elitës që pritet të startojë nga kjo javë. Klubet janë të gatshme për sezonin e ri, ashtu si dhe Federata e Futbollit të Kosovës, e cila thuhet se i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e stinorit të ri.

Sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu në një intervistë për "KosovaPress" fillimisht u shpreh se FFK-ja ka filluar qysh moti me përgatitjet për stinorin e ri dhe tanimë është gjithçka gati. "Si zakonisht, ju e dini që punimet për sezonin e ri fillojnë shumë herët, menjëherë përfundimit të stinorit të rregullt. Kemi pasur lojë të barazhit që ka qenë pak më e komplikuar, lojërat e përfaqësueses. Pra, aktivitetet në Federatë nuk pushojnë... Sa i përket FFK-së, është një rutinë e cila tashmë u rrit në një nivel më të lartë se herëve të tjera", ka thënë Salihu, i cili ka vazhduar tutje duke treguar edhe për formatin e ri të Superligës. Ai ka bërë të ditur se sezonin e ardhshëm nga Superliga do të bien 4 skuadra në Ligën e Parë, ndërsa 3 ekipe sipas të gjitha gjasave do të shkojnë në garat ndërkombëtare, edhe pse ende nuk është bërë zyrtare asgjë. Ai kritikoi ashpër skuadrat të cilat morën pjesë në garat ndërkombëtare, duke thënë se ato nuk kanë arritur ndonjë sukses, i cili mund t'i ndihmonte atyre dhe Federatës. "Nga sezoni i ardhshëm, Superligën do ta përfaqësojnë vetëm 10 ekipe, pra do të bien katër, por në garat ndërkombëtare akoma nuk është bërë koeficienti dhe unë mendoj se do të shkohet me tri... Për fat të keq ekipet tona nuk u treguan as sivjet të mira, tani duhet me tregu realitetin. Niveli më i ulët i garave ndërkombëtare evropiane është kjo dhe ne nuk kemi arrit ta kalojmë, përpos ndoshta nga një klub. Te kishim kaluar edhe një fazë më lartë, sigurisht që do të kishim edhe ekipe tjera", ka shtuar Salihu. Sipas tij, pikërisht këto dy fakte e bëjnë sezonin e ardhshëm të Superligës tejet interesant dhe skuadrat sipas tij do të kenë një sezon tejet të ngjeshur, disa prej tyre duke u munduar të ikin nga rënia në Ligën e Parë, e disa tjera për të siguruar një vend që dërgon në garat ndërkombëtare. I pyetur se a mendon që skuadrat janë gati, Salihu u përgjigj se disa prej tyre po, ndërsa vazhdoi duke kritikuar disa skuadra të cilat sipas tij sezonin e kaluar janë marrë më shumë me politikë se sa me futboll. "Unë mendoj se disa ekipe janë gati, për fat të keq po e them sinqerisht që disa ekipe më shumë janë marrë me politikë se sa që e kanë shikuar vetveten dhe kjo pastaj u pa edhe në gara ndërkombëtare. Klubet duhet të mos merren me politikë, t'i kryejnë punët e tyre. Ato kanë sjellë edhe pasiguri në ekipe tjera edhe te organet tjera dhe te komisionet tona. Shpresoj që klubet janë vetëdijesuar dhe e kanë kuptuar se klubi është për të zhvilluar gjenerata të reja, për me pas sukses, me luajt futboll dhe jo me bë politikë", përfundoi Salihu.

**JAVA E PARË E SUPERLIGËS**

Të shtunën takohen:
17:00 Feronikeli - Drenica
17:00 Flamurtari - Prishtina
17:00 Llapi - Vushtrria
Të dielën takohen:
17:00 Drita - Ferizaj
17:00 Trepça'89 - Gjilani
17:00 Dukagjini - Ballkani

# NBA nis më 22 tetor, derbi Lakers-Clippers në ditën e parë



**Los Angeles, 13 gusht** - NBA ka zyrtarizuar sot kalendarin e sezonit të ri 2019-2020. Sezoni i rregullt do të nisë më 22 tetor dhe do të përfundojë më 15 prill për t'i lënë më pas vendin fazës "play-off" (18 prill). Që në start kampionati do të ofrojë një super-ndeshje, derbin e Los Angelosit mes Clippersit dhe Lakersit. Pra, LeBron Jamesi do ta sfidojë Kawhi Leonardon. Ndërsa kampionët në fuqi të Toronto Raptorsit do ta nisin mbrojtjen e titullit me New Orleans Pelicansin. Më 11 nëntor Leonard do të rikthehet në Kanada dhe do të luajë për herë të parë si rival i Torontos, ekip me të cilin u shpall kampion sezonin e fundit. Në këtë ndeshje ai do ta marrë edhe unazën e titullit kampion para ish-publikut të tij. Derbi Lakers-Clippers do të përsëritet edhe për Krishtlindje, në një mbrëmje magjike ku do të luhet edhe ndeshja mes Houstonit dhe Golden States. Më 25 dhjetor në Lindje do të luhen ndeshjet Milwaukee-Philadelphia dhe Toronto-Boston. Russell Westbrook më 20 janar (ditën e Martin Luther Kingut) do të luajë për herë të parë si lojtar i Houstonit ndaj ish-ekipit të tij Oklahoma. Po atë ditë do të luhet edhe klasikja e NBA-së mes Bostonit dhe Lakersit.

## SHKURT

### Bayerni merr në huazim Perisiqin

Tashmë është bërë zyrtare kalimi i Ivan Perisiqit në Bayern Munchen. Kroati është huazuar nga Interi deri më 30 qershor të vitit 2020. Skuadra gjermane ka në opsion të drejtën e blerjes, kurse ai pritet të jetë një armë e fuqishme në repartin e sulmit ku Bayerni ka mungesën më të madhe që prej largimit të dy legjendave: Franck Ribery dhe Arjen Robben.

### Pensionohet Sneijderi

Wesley Sneijder i ka thënë lamtumirë futbollit të luajtur në moshën 35-vjeçare. Pas mbylli kontratën sezonin e kaluar me skuadrën e Al-Gharafa-s në Katar, Wesley Sneijder u afrua në klubin e qytetit të tij Utrehtit, ku do të jetë pjesë e drejtuesve të skuadrës. Ai mban rekordin në kombëtaren holandeze me 134 ndeshje të luajtura dhe ka luajtur me Ajaxin, Real Madridin, Interin ku fitoi edhe Ligën e Kampionëve, Galatasarayn dhe Nicen.

### Rugani, afër Romës

Mbrojtësi italian i Juventusit, Daniele Rugani, është pranë transferimit te Roma. Ai pritet të huazohet për pesë milionë euro, ndërsa skuadra romane do të ketë edhe obligim për ta blerë mbrojtësin verën e ardhshme për 25 milionë euro, bën të ditur "Corriere dello Sport". Ndërkohë, Roma, po ashtu, po interesohet për ta huazuar nga Juventusi sulmuesin argjentinas Gonzalo Higuain.

### 13 skuadra pas Sturridget

Sulmuesi Daniel Sturridge është lojtar i lirë, pasi kontrata me skuadrën e Liverpoolit i ka përfunduar. "The Times" raporton se për sulmuesin anglez janë 13 skuadra të interesuara, përfshirë thuajse të gjitha ligat. Atalanta dhe Bologna nga Italia, Betisi, Leganes dhe Valladolid nga liga elitare e Spanjës, kurse në Gjermani e dëshiron Frankfurti. Në Francë, 29-vjeçari kërkohet nga Marseille, derisa në Turqi nga Fenerbahçe. Skuadrat e fundit që po interesohen për ish-anëtarin e Chelseat janë në Amerikë DC United dhe Philadelphia.

### Lampard: Ndaj Liverpoolit nuk ka arsyetime

Trajneri i Chelseat, Frank Lampard, u ka bërë me dije lojtarëve të tij se nuk mund të kenë arsyetime për finalen e sotme ndaj Liverpoolit. "Ndeshja në finale ndaj një skuadre të kualitetit të Liverpoolit do të jetë e tensionuar siç janë zakonisht finalet. Çdo lojtar duhet të jetë në dijeni për rëndësinë e kësaj ndeshje dhe duhet të japë çdo gjë nga vetja sepse do të jetë shumë e vështirë. Nuk mund të themi pas ndeshjes, 'Oh, kemi mundur ta bëjmë këtë', 'E humbëm atë shans', 'Nuk ishim plotësisht gati', nuk ka vend për arsyetime", ka thënë Lampardi.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | QË ZHVILLOHET ME FORCË E SHPEJT | E KËPUTUR; E MPAKUR | VERBAND OSTBELGIS. RADSPORTLER | AKTORI REXHEPI | KOMIKU I SHQUAR ... CARREY (origj.) | I GJYMTOVA | TRAJNERI ISMET ...... (LLAMKOS KOSOVA) | EPOKA E RE | ZANORE | QËLLIM I PARAMENDUAR, PARAMENDIM | NUMËR THEMELOR |
| | | | | | | SHMANGIE | | | | | | | | VEPËR E KRYER, PUNË / SHKRIMTARI GJERMAN ERIK MARIA | | | |
| | | | | | | SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR | | | | | | | | | DUKAT | | |
| | | | | | | SHKRIMTARJA KAMBERI | | | | | | | | | SELEN / KALIBRI I TYTËS SË ARMËS | | |
| | | | | | | ADRIAN KRASNIQI | | | BASHKËT. / FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO | | VLERË, DOBI (krah.) / BASHKËT. | | | | | | DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME |
| | | | | | | AKTORJA E FAMSHME DEMI ... (shqip.) | | | | GOCAT / TITAN, LITËR | | | | | | BASHKËT. / PJESË ERRËT E DITËS | |
| | | | | | | PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (vjet.) | | | | | DESPOTI / PAJISJE PËR DREJTIMIN E VETURËS | | | | | | |
| | | | | | | KRUJA | | RYSHFET / ELEMENT KIMIK | | | | | GRUP MAFIOZ / I KËTIJ ÇASTI, I KËSAJ KOHE | | | | |
| EPOKA E RE | KEQTINGËLLIM | TË FIKËT | NDËRTESË E POSAÇME KU SHFAQEN FILMA | POLITIKANI FERID | EPOKA E RE | PËREMËR VETOR | SHTET NË AMERIKË (pashq.) / BLETA QË IKËN NGA ZGJOI I VET | | | | | | | TRAJNERI GJERMAN REHAGEL | | | |
| FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN LEITE .... | | | | | LAJ NË AR, PRAROJ / ZANORE | | | | | KRAHINË NË SHQIPËRI / PRESIDENTI AMERIKAN ..... OBAMA | | | | FAMË / BAKRI | | | |
| LLOJ KROKODILI | | | | | | | | | BEDRI OSMANI / BURNT ORANGE REPORT | | | FLORIRI / GRUMBULLIM | | | | SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA | FEMRA E KALIT (sh.shq.) |
| SHTET I MADH NË AZI | | | | | ADEM JASHARI | | | BIMË E VENDEVE TË NXEHTA / BASHKËT. | | | | | | | DY BASHKËTINGËLLORE / EMPOLI | | |
| ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL (LIVERPOOL) | | | | | DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË | GAZ PËR DEZINFEKTIMIN E UJIT / RILINDËSI NË FOTO .... VRETO | | | | | EMËR YNI FEMRE / VETURAT, AUTOMJETET | | | | | | |
| NJËSI E VOGËL E ORGANIZIMIT TË JETËS SHOQËRORE | | | | | | | | POLITIKANI HARADINAJ (shq.) / BERAT LUZHA | | | | | | | ANNA LEE / TOKA E BUKËS | | |
| OKSIGJEN, NATRIUM | | | | SHKRONJA TË NJËJTA / GOTË PREJ BAKRI | | | BELGJIKA / EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN | | THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI / "I" para dy "E" | | | | | MA JEP / ISH BOKSIERI LIKA (shq.) | | | |
| NAIM ISMAJLI | | | RRUGA E HAPUR NËN KODËR / MBATHËSET SPORTIVE | | | | | | | BIXHOZ / BASHKËT. | | | | | | BASHKËT. / FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN .... | |
| ZANORE | | KRITER / PATRIOTI PRISHTINA (shq.) | | | | | | SHKRIMTARI .... ZOLA / KËNGËTARJA .... KONÇI | | | | | KAFENE, RESTORANT / VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE | | | | SHTET NË AZI ...... LINDOR |
| EPOKA E RE | KRAHINË NË KOSOVË / NJËSI MATJEJE (sh.shq.) | | | | | OPEN MICROSCOPY ENVIRONMENT / KOMPOZITORI KOCI (shq.) | | | | MARKË E VESHJEVE SPORTIVE / PRIFT HEBRAIK | | | | | UGANDA, TANZANIA / KËNGËTARJA JONË ..... TAKE | | |
| LUMË NË SHQIPËRI | | | | HUQ, VES / NËNË | | | | | SHKRIMTARI HAZIRI (shq.) / AKTORJA E FAMSHME .... REID | | | | | | | | |
| LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI | | | | | LETRAT / ARTAN (perkdh.) | | | | | | | VËNIE E MINAVE / BASHKËT. | | | | | |
| NJERIU QË KA NDONJË GJYMTYRË ME CEN A TË PARALIZUAR | | | | | | | KOLEGJ UNIVERSITAR NË KOSOVË / ZANORE | | | | ISH DIZENJATORI ITALIAN VERSAÇI / MARC ANTHONY | | | | | ZANORE / ERMELINDA MEKSI | |
| ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER | | | | | | | | FUTBOLLISTI ANGLEZ FERDINAND / BASHKËT. | | | | KALORËS MESJETAR / PRAGA | | | | | |
| KOLOSI | | | | | | | NDENJËSE E GJATË KU MUND TË RRINË KATËR-PESË VETA | | | | | | | LLOJ VETURE FRANCEZE | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria*
*Vlada-Government*
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

**Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services**

## NJOFTIM PER VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Ministria e Zhvillimit Ekonomik zgjat afatin edhe për shtatë ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve në Konkursin për pozitat:

**Divizioni për Komunikim Publik**
